



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.184

dhjetor

2011

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.929, datë 21.12.2011	Për autorizimin e shoqërisë “Kurum Internacional” sh.a., për importin e mbetjeve metalike të hekurit dhe të çelikut, për qëllime riciklimi..... 10253
Udhëzim i MBUMK nr.5, datë 25.3.2011	Për kërkesat specifike të higjienës për stabilimentet e prodhimit, grumbullimit dhe përpunimit të qumështit, dhe produkteve me bazë qumështi..... 10254
Vendim i GJL nr.5, datë 31.5.2011	Me objekt detyrimin e të paditurit për të më liruar sipërfaqen e truallit prej 80 m ² 10262
Vendim i ERE nr.147/1, datë 7.12.2011	Për përcaktimin e tarifës së aksesit në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën e tretë rregullatore..... 10274
Vendim i ERE nr.152, datë 7.12.2011	Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga “Hec Bistrica 1, 2” sh.a. për periudhën e tretë rregullatore..... 10275
Vendim i ERE nr.153, datë 7.12.2011	Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga “Hec Lanabregas” sh.a. për periudhën e tretë rregullatore..... 10275
Vendim i ERE nr.154, datë 7.12.2011	Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga “Hec Ulëz Shkopet” sh.a. për periudhën e tretë rregullatore.... 10276
	Tabelat e munguara të vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.359, datë 4.5.2011 dhe nr.822, datë 23.11.2011..... 10277

VENDIM
Nr.929, datë 21.12.2011

PËR AUTORIZIMIN E SHOQËRISË “KURUM INTERNACIONAL” SHA PËR IMPORTIN E MBETJEVE METALIKE TË HEKURIT DHE TË ÇELIKUT, PËR QËLLIME RICIKLIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 22 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar dhe të pikës 2 të nenit 49 të ligjit nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e shoqërisë “Kurum Internacional”, sh.a., për importin e mbetjeve metalike të hekurit dhe çelikut, me kodet GA 720410, GA 720429, GA 720430, GA 720441, GA 720449 dhe B1-B1010, të Konventës së Bazelit, anekset 1 e 2 “Mbetjet e listës së gjelbër”, referuar vendimit n.825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen, për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”, për qëllime riciklimi, si më poshtë vijon:

- GA 720410 mbetje dhe kthime të gizës së derdhur;
- GA 720429 mbetje dhe kthime të çelikeve të lidhura;
- GA 720430 mbetje dhe kthime të gizës dhe çelikut të kallajisur;
- GA 720441 copa të vogla lëmimi, mbetje nga zburimet dhe stampimet, nëse janë apo jo në tufë.
- GA 720449 mbetje të fragmentizuara, ashkla.

2. Sasia e mbetjeve metalike të hekurit dhe çelikut, që importohet sipas kodeve të referuara në pikën 1 të këtij vendimi është 600 000 (gjashtëqind mijë) tonë.

3. Mbetjet importohen nga Serbia dhe Bullgaria, duke kaluar transit nëpërmjet Malit të Zi dhe Maqedonisë. Transporti bëhet në rrugë tokësore, duke plotësuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor për transportin ndërkombëtar të mbetjeve, si dhe kërkesat e kreut II të vendimit nr.806, datë 4.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për importimin e mbetjeve për përdorim, përpunim dhe riciklim”.

4. Periudha e lejimit të importit të mbetjeve metalike të hekurit dhe çelikut, nga “Kurum Internacional” sh.a., të jetë për një afat kohor njëvjeçar, që do të fillojë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

5. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në zbatim të kërkesave të mësipërme ligjore, merr masat e nevojshme për kontrollin e procesit të riciklimit të mbetjeve metalike të hekurit dhe çelikut, nga “Kurum Internacional” sh.a. pas miratimit të këtij vendimi, për të siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit të njeriut.

6. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave komunikon, me shkrim, me shtetet eksportuese dhe ato të kalimit transit të kësaj sasive të mbetjeve metalike të hekurit dhe të çelikut, në përmbushje të kërkesave të konventës së Bazelit “Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimit të tyre”, në të cilën Republika e Shqipërisë është palë.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



UDHËZIM
Nr.5, datë 25.3.2011

**PËR KËRKESAT SPECIFIKE TË HIGJENËS PËR STABILIMENTET E PRODHIMIT,
GRUMBULLIMIT DHE PËRPUNIMIT TË QUMËSHTIT, DHE PRODUKTEVE ME BAZË
QUMËSHTI**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, nenit 23, pika 1 dhe 2 të ligjit nr.9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”,

UDHËZOJ:

PJESA I
TË PËRGJITHSHME

1. Ky udhëzim përcakton kërkesat specifike shëndetësore dhe të higjienës për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe shpërndarjen e qumështit të papërpunuar dhe produkteve me bazë qumështi dhe kontrollet zyrtare të tyre.

2. Ky udhëzim nuk zbatohet për:

- a) prodhimin primar për përdorim vetjak;
- b) përgatitjen, trajtimin ose ruajtjen e ushqimit për konsum vetjak;
- c) furnizimin direkt nga prodhuesi, të sasive të vogla të qumështit të papërpunuar te konsumatori i fundit ose te pikat lokale të pakicës që furnizojnë direkt konsumatorin e fundit lokal;
- d) shitjen me pakicë, për veprimet me qëllim furnizimin e një pike tjetër, kur:
 - i) operacionet kanë të bëjnë vetëm në depozitim ose transportin, rast në të cilin zbatohen kërkesat specifike të temperaturës, së përcaktuara në pikat 31 dhe 32; ose
 - ii) furnizimi bëhet nga pika e pakicës vetëm te një pikë tjetër pakice dhe, në përputhje me legjislacionin në fuqi është një aktivitet i lokalizuar dhe i kufizuar.

3. Për qëllim të këtij udhëzimi, do të zbatohen përkufizimet e përcaktuara në ligjin “Për ushqimin”, nr.9863, datë 28.1.2008 dhe termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

- a) “Qumësht i papërpunuar” quhet qumështi i prodhuar nga sekretimi i gjëndrave të qumështit të kafshëve të fermës, i cili nuk është ngrohur mbi 40°C ose nuk i është nënshtruar asnjë veprimi që ka efekt të ngjashëm.
- b) “Fermë qumështi” është stabilimenti ku mbarështohen një ose më shumë kafshë (lopë, buallica, dhi ose dele) për prodhimin e qumështit që do të vendoset në treg si ushqim;
- c) “Produkte me bazë qumështi” quhen produktet e përpunuara, të përfituara nga përpunimi i qumështit të papërpunuar ose nga përpunimi i mëtejshëm i këtyre produkteve të përpunuara.
- d) “Autoriteti kompetent” quhet Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe strukturat e tij inspektuese.

PJESA II
**KËRKESAT SPECIFIKE NË LIDHJE ME FERMAT E PRODHIMIT TË QUMËSHTIT, QUMËSHTIT
TË PAPËRPUNUAR DHE PRODUKTEVE ME BAZË QUMËSHTI**

1. Operatorët e biznesit ushqimor që prodhojnë ose grumbullojnë qumështin e papërpunuar, duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- a) kërkesat për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve sipas legjislacionit në fuqi;
- b) kërkesat e përgjithshme të higjienës për prodhimin e ushqimit dhe/ose stabilimentet e përpunimit, të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit “Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor”;

c) qumështi i papërpunuar, që do të përdoret për konsum njerëzor, të plotësojë kërkesat e higjienës të përcaktuara në këtë udhëzim;

d) kërkesat e gjurmëshmërisë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Për këtë qëllim, ato duhet të mbajnë të dhëna për çdo kafshë të stabilimentit, në veçanti, të: numrit të identifikimit të kafshës, të dhëna personale të pronarit, adresën, ekzaminimin klinik, diagnostik dhe laboratorik të kafshës.

2. Nëse kërkesat e pikës 1 nuk plotësohen, autoriteti kompetent ndalon aktivitetin e biznesit ushqimor për prodhimin ose grumbullimin e qumështit të papërpunuar dhe nxjerrjen në treg të qumështit të papërpunuar.

3. Qumështi vlerësohet me kontrollin fizik dhe testimet laboratorike, si:

- a) i përshtatshëm për konsum njerëzor;
- b) i papërshtatshëm për konsum njerëzor;
- c) i përshtatshëm me kusht për konsum njerëzor.

4. Qumështi lëndë e parë konsiderohet i përshtatshëm për konsum njerëzor nëse përftohet nga kafshët:

a) të cilat nuk shfaqin shenja të sëmundjeve ngjitëse, të transmetueshme te njeriu nëpërmjet qumështit;

b) që janë në gjendje të përgjithshme shëndetësore të mirë, nuk paraqesin asnjë shenjë të sëmundjes që mund të kontaminojnë qumështin dhe, në veçanti, që nuk vuajnë nga infeksione të aparatit gjenital me rrjedhje, nga sëmundje të aparatit tretës të shoqëruara me diarre dhe temperaturë ose nga infeksione të dallueshme të gjirit;

c) të cilat nuk kanë plagë të gjirit, që mund të ndikojnë negativisht në qumësht;

d) të cilat nuk janë trajtuar me lëndë ose produkte të rrezikshme për shëndetin e njeriut, të paligjshme sipas legjislacionit në fuqi; dhe

e) për të cilat, nëse janë përdorur substanca apo produkte të lejuara, janë respektuar afatet e parashikuara të tërheqjes së këtyre produkteve ose lëndëve.

5. Në veçanti, për sa i përket brucelozës, qumështi i papërpunuar duhet të përftohet prej:

- i) lopëve ose buajve që i përkasin një tufe zyrtarisht të paprekur nga bruceloza;
- ii) deleve ose dhive të cilat i përkasin një ferme zyrtarisht të paprekur nga bruceloza; ose
- iii) femrave që i përkasin specieve të tjera, për specie të dyshuara për brucelozë, për tufat e kontrolluara rregullisht për këtë sëmundje sipas një plani kontrolli të aprovuar nga autoriteti kompetent.

6. Për sa i përket tuberkulozit, qumështi i papërpunuar duhet të përftohet prej:

- a) lopëve ose buajve që i përkasin një tufe zyrtarisht të paprekur nga tuberkulozi; ose
- b) femrave që u përkasin specieve të tjera, për specie të dyshuara për tuberkuloz, për tufat e kontrolluara rregullisht për këtë sëmundje sipas një plani kontrolli të aprovuar nga autoriteti kompetent.

7. Nëse në një fermë mbahen së bashku dhi dhe lopë, dhitë t'u nënshtrohen kontrollit për tuberkulozin.

8. Pa cenuar pikën 4, qumështi i papërpunuar konsiderohet i papërshtatshëm për konsum njerëzor:

- a) nëse është i papastër, i kontaminuar ose i ndotur në mënyrë të dukshme;
- b) nëse konservohet me substanca kimike ose nëse përmban substanca të palejuara;
- c) nëse ngjyra, shija, era dhe konsistenca janë ndryshuar;
- d) nëse nuk plotëson kriteret mikrobiologjike;
- e) nëse kontaminimi përcaktohet me radio nukleotide mbi nivelin e lejuar të aktivitetit.

9. Qumështi i papërpunuar, i papërshtatshëm për konsum njerëzor nuk nxirret në treg, por me autorizim ose udhëzime të përshtatshme nga autoriteti kompetent:

a) mund të përdoret për qëllime teknike ose si ushqim për kafshë vetëm pas përpunimit të përshtatshëm; ose

b) konfiskohet ose eliminohet, në mënyrë që të parandalohet përhapja e sëmundjeve ngjitëse ose çdo rrezik tjetër për shëndetin e njerëzve ose të kafshëve.



10. Megjithatë, qumështi i papërpunuar, i prodhuar nga kafshët që nuk i plotësojnë kërkesat e pikave 5, 6 dhe 7, mund të jetë i përshtatshëm me kusht, me autorizimin e autoritetit kompetent:

a) në rastin e lopëve ose të buajve që nuk tregojnë reaksion pozitiv ndaj testeve për tuberkuloz ose brucelozë, as ndonjë simptomë të këtyre sëmundjeve, pasi i është nënshtruar një trajtimi termik, të tillë që të tregojë një reaksion negativ të testit të fosfatazës;

b) në rastin e deleve ose dhive që nuk tregojnë reaksion pozitiv ndaj testeve të brucelozës, ose të cilat janë vaksinuar kundër brucelozës, si pjesë e një programi vaksinimi të miratuar dhe që nuk shfaqin ndonjë simptomë të kësaj sëmundjeje, ose:

i) për prodhimin e djathit me një periudhë staxhionimi, të paktën dy muaj; ose

ii) pasi i është nënshtruar një përpunimi termik, të tillë që të tregojë një reaksion negativ ndaj testit të fosfatazës; dhe

c) në rastin e femrave të kafshëve të llojeve të tjera, të cilat nuk tregojnë një reaksion pozitiv ndaj testeve të tuberkulozit ose brucelozës dhe as ndonjë simptomë të këtyre sëmundjeve, por që i përkasin një tufe të prekur nga brucelozë ose tuberkulozi konstatuar nga kontrollet e referuara në pikën 5 (iii) dhe 6 (b), nëse trajtohet për të garantuar sigurinë e tij.

11. Qumështi i papërpunuar, përfutur nga kafshë që nuk plotësojnë kërkesat e pikave 4, 5, 6, 7 dhe 10, në veçanti, çdo kafshë që shfaq individualisht një reaksion pozitiv ndaj testeve profilaktike zyrtare të tuberkulozit ose brucelozës, nuk duhet të përdoret për konsum njerëzor, përveçse kur trajtohet me nxehtësi ose me UHT ose me pasterizim të dyfishtë për një kohë të shkurtër, sipas pikave 33 dhe 34.

12. Izolimi i kafshëve të infektuara, ose që dyshohen të jenë infektuar, me ndonjë prej sëmundjeve të referuara në pikën 4, 5 ose 6, 7, duhet të jetë efektiv, për të shmangur çdo efekt të kundërt mbi qumështin e kafshëve të tjera.

13. Pajisjet e mjeljes dhe ambientet e ruajtjes, përpunimit ose ftohjes së qumështit, të vendosen dhe të ndërtohen në mënyrë të tillë që të kufizojnë rrezikun e kontaminimit të qumështit.

14. Ambientet për ruajtjen e qumështit të jenë të mbrojtura nga parazitët, të kenë ndarje të përshtatshme nga ambientet ku strehohen kafshët, të përmbushin kërkesat e përcaktuara në pikat 4, 5, 6 dhe 7 dhe të kenë pajisje të përshtatshme frigoriferike.

15. Sipërfaqet e pajisjeve që janë në kontakt me qumështin (enët, mbajtëset e qumështit, rezervuarët, që përdoren për mjeljen, grumbullimin ose transportin e qumështit) duhet të jenë lehtësisht të pastrueshme e dezinfektueshme dhe të mbahen në kushte të mira. Kjo kërkon përdorimin e materialeve të lëmuara, që lahen lehtë dhe jotoksike.

16. Pas përfundimit të mjeljes, këto sipërfaqe duhet të pastrohen dhe, kur është e nevojshme, të dezinfektohen. Pas çdo mjeljeje, ose pas çdo serie përdorimi, gjatë së cilës ka hapësira të vogla kohore ndërmjet zbrazjes dhe mbushjes pasardhëse, por në të gjitha rastet, të paktën një herë në ditë, enët e mjeljes, makinat mjelëse mekanike dhe enët mbajtëse në kontakt me qumështin, tanket dhe kontejnerët e qumështit të përdorura për transportin e qumështit të papërpunuar duhet të pastrohen dhe dezinfektohen në mënyrën e duhur përpara se ato të përdoren përsëri.

17. Ambientet në të cilat ruhet dhe përpunohet qumështi, si dhe enët dhe pajisjet të cilat bien në kontakt me qumështin gjatë procesit të prodhimit, përpunimit dhe transportit, duhet të përmbushin kërkesat përkatëse të përcaktuara në këtë udhëzim.

18. Mjelja të bëhet duke respektuar kushtet higjienike, duke bërë të mundur, në veçanti:

a) që, përpara fillimit të mjeljes, thithët, gjiri dhe pjesët e afërta, të jenë të pastra;

b) që qumështi i përfutur nga çdo kafshë të kontrollohet për anomalitë organo-leptike ose fiziko-kimike nga mjelësi ose më një metodë që jep rezultate të ngjashme dhe që qumështi që paraqet këto anomalitë nuk përdoret për konsum njerëzor;

c) që qumështi i përfutur prej kafshëve që paraqesin shenja klinike të sëmundjeve të gjirit të mos përdoret për konsum njerëzor, përveç rasteve kur udhëzon veterineri;

d) identifikimin e kafshëve që i nënshtrohen trajtimit mjekësor, të cilat kanë mundësi t'i transmetojnë mbetjet të qumështit, dhe që ky qumësht i përfutur nga këto kafshë të mos përdoret për konsum njerëzor përpara përfundimit të periudhës së parashikuar të tërheqjes; dhe

e) që për thithkat të përdoren vetëm solucione të miratuara nga autoriteti kompetent.

19. Menjëherë pas mjeljes, qumështi duhet të mbahet në një vend të caktuar, të pastër, i tillë që të shmangë çdo kontaminim. Ai duhet të ftohet menjëherë në temperaturë jo më shumë se 8°C në rast të grumbullimit ditor, ose jo më shumë se 6°C nëse grumbullimi nuk është ditor.

20. Gjatë transportit duhet të ruhet sistemi i ftohjes dhe me mbërritjen në stabilimentin përpunues, temperatura e qumështit nuk duhet të jetë më e lartë se 10°C.

21. Operatorët e biznesit ushqimor nuk zbatojnë kërkesat e temperaturës të përcaktuara në pikën 19 dhe 20 në qoftë se qumështi përmbush kriteret e përcaktuara në pikën 27, 28, 29 dhe ose:

a) kur qumështi përpunohet brenda dy orëve nga mjelja; ose

b) kur është e nevojshme një temperaturë më e lartë për qëllime teknologjike për prodhimin e produkteve të caktuara me bazë qumështi, autorizuar nga autoriteti kompetent.

22. Gjatë mjeljes dhe grumbullimit duhet të tregohet kujdesi i duhur për parandalimin e kontaminimit të jashtëm dhe për të siguruar mbrojtjen nga kushtet atmosferike.

23. Qumështi që nuk është i ambalazhuar ngarkohet në cisterna, kontejnerë ose enë speciale. Qumështi i ambalazhuar mbushet në ambalazhe të përshtatshme plastike ushqimore ose ambalazhe të tjera. Cisternat, kontejnerët ose enët të cilat përdoren për transportimin e qumështit nuk duhet të përdoren për transportin e lëndëve të tjera.

24. Mjetet e transportit dhe kontejnerët për qumështin dhe produktet me bazë qumështi duhet të përmbushin kushtet e mëposhtme:

a) sipërfaqja e tyre e brendshme duhet të jetë prej materiali që mund të pastrohet, lahet dhe dezinfektohet lehtë;

b) duhet të kenë dysheme e cila pastrohet lehtë me sipërfaqe të lëmuar dhe e tillë që ujërat të rrjedhin pa vështirësi;

c) duhet të ndërtohen në mënyrë të tillë që të evitohet ndotja me kontaminantë dhe aroma dhe të ketë sistem ventilimi;

d) të jenë të mbrojtur nga çdo agjent atmosferik dhe pluhur;

e) mjetet specifike të transportit, përveç kushteve të referuara në pikat “a”, “b”, “c” dhe “d”, duhet të kenë pajisje ftohëse dhe burime ftohëse shtesë dhe pajisje për rregullimin e temperaturës në mjetin e transportit, në mënyrë që të ruajë temperaturën konstante të ngarkesës gjatë ngarkimit dhe transportit;

f) Cisternat për transportimin e qumështit të jenë të izoluara termikisht dhe të lehta për t'u pastruar dhe dezinfektuar.

25. Personat që kryejnë mjeljen dhe/ose trajtimin e mëtejshëm të qumështit të papërpunuar duhet të veshin veshje pune të pastra e të përshtatshme.

26. Personat që kryejnë mjeljen duhet të mbajnë një shkallë të lartë të higjienës personale. Në vendin e mjeljes duhet të ketë pajisje të përshtatshme për larjen dhe dezinfektimin e duarve, në mënyrë që personat që kryejnë mjeljen dhe trajtimin e qumështit të papërpunuar të kenë të mundur larjen dhe dezinfektimin e duarve dhe të krahëve.

27. Një numër mostrash përfaqësuese të qumështit të papërpunuar të grumbulluara nga fermat, të marra në mënyrë të rastësishme, duhet të kontrollohen për përputhshmërinë me pikat 28 dhe 29. Kontrollat mund të kryhen nga ose për llogari të:

a) operatorëve të biznesit ushqimor që prodhojnë qumësht;

b) operatorëve të biznesit ushqimor që grumbullojnë ose përpunojnë qumështin;

c) një grupi të operatorëve të biznesit ushqimor ose në kontekstin e një skeme kontrolli zyrtar, kombëtare ose rajonale.

28.a) Operatorët e biznesit ushqimor të fillojnë procedurat për të siguruar që qumështi i papërpunuar përmbush kriteret (normat) e mëposhtme:



- i) për qumështin e papërpunuar të lopës: Përmbajtja e mikroflorës së përgjithshme (mezofile aerobike) në 30°C (për ml) të jetë 100 000¹ dhe përmbajtja e qelizave somatike (për ml), 400 000²;
 - ii) për qumështin e papërpunuar të përftuar nga kafshë të tjera: Përmbajtja e mikroflorës së përgjithshme (mezofile aerobike) në 30°C (për ml) të jetë 1 500 000¹;
 - b) Në qoftë se qumështi i papërpunuar i përftuar nga kafshë të tjera nga lopët, përdoret për prodhimin e produkteve me bazë qumështi me një proces që nuk përfshin trajtimin termik, operatorët e biznesit ushqimor duhet të marrin masa për të siguruar që qumështi i papërpunuar i përdorur plotëson normat e mëposhtme:
Përmbajtja e mikroflorës së përgjithshme (mezofile aerobike) në 30°C (për ml), 500 000¹.
29. Operatorët e biznesit ushqimor, pa përjashtuar legjislacionin në fuqi për mbetjet, duhet të ndërmarrin procedurat për të siguruar që qumështi i papërpunuar nuk nxirret në treg nëse:
- a) përmban mbetje antibiotiku në një sasi që i kalon nivelet e lejuara nga legjislacioni në fuqi; ose
 - b) totali i mbetjeve të substancave antibiotike kalon çdo vlerë maksimale të lejuar.
30. Kur qumështi i papërpunuar nuk përmbush kërkesat e pikave 28 ose 29, operatori i biznesit ushqimor duhet të informojë autoritetin kompetent dhe të marrë masa për të korrigjuar situatën.
31. Operatorët e biznesit ushqimor duhet të sigurojnë që, nga momenti i pranimit në stabilimentet e përpunimit, qumështi duhet të ftohet menjëherë në një temperaturë jo më lartë se 6°C dhe të ruhet në këtë temperaturë deri në trajtimin termik të tij.
32. Operatorët e biznesit ushqimor mund ta mbajnë qumështin në një temperaturë më të lartë në qoftë se:
- a) përpunimi fillon menjëherë pas mjeljes ose brenda katër orëve nga momenti i pranimit në stabilimentin e përpunimit; ose
 - b) autoriteti kompetent lejon një temperaturë më të lartë për qëllime teknologjike për prodhimin e produkteve të caktuara me bazë qumështi.
33. Kur qumështi i papërpunuar ose produktet me bazë qumështi i nënshtrohen trajtimit termik, operatorët e biznesit ushqimor duhet të sigurojnë që ky trajtim përmbush kërkesat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Në veçanti, ato duhet të sigurojnë që, kur përdorin proceset e mëposhtme, të plotësojnë kërkesat përkatëse:
- a) Pasterizimi sigurohet nëpërmjet ngrohjes:
 - i) në temperatura të larta për një periudhë kohe të shkurtër (të paktën 15 sekonda në 72°C për); ose
 - ii) në temperaturë të ulët për një kohë të gjatë (të paktën 63°C për 30 minuta); ose
 - iii) çdo kombinim tjetër të temperaturës me kohën për arritjen e një efekti të ngjashëm, në mënyrë që produktet të tregojnë, një reaksion negativ ndaj testit të fosfatazës, menjëherë pas një trajtimi të tillë.
 - b) trajtim me temperaturë ultra të lartë (UHT) sigurohet nëpërmjet:
 - i) veprimi për një kohë të shkurtër të një rryme të nxehtë, të vazhdueshme, me temperaturë të lartë (jo më pak se 135°C, e kombinuar me një periudhë kohe të përshtatshme), mbi qumështin lëndë e parë, në mënyrë që të mos ketë mikroorganizma të gjalla ose spore të tyre të afta për t'u rritur në produktin e trajtuar kur mbahet në një kontejner të mbyllur steril në temperaturë ambiente; dhe

¹ Mesatarja gjeometrike, llogaritur për një periudhë mbi dymujore, me të paktën dy prova në muaj.

² Mesatarja gjeometrike, llogaritur për një periudhë mbi tremujore, me të paktën një provë në muaj, përveçse në rastet kur autoriteti kompetent specifikon një metodologji tjetër duke marrë parasysh ndryshimet sezonale në nivelet e prodhimit.

- ii) Të konservohet në mënyrë të tillë, që të mos paraqesë ndryshime të dukshme pas ruajtjes për 15 ditë në një enë të mbyllur në temperaturën +30°C, ose sipas rastit mund të përdoret si kriter dhe një ruajtje shtatëditore në një enë të mbyllur në një temperaturë +55°C ose ndonjë metodë tjetër e tillë që të zbatohet trajtimi termik i duhur.

34. Kur gjykohet që qumështi lëndë e parë t'i nënshtrohet një trajtimi termik, operatorët e biznesit ushqimor:

a) duhet të respektojnë procedurat e hartuara në përputhje me parimet HACCP në bazë të legjislacionit në fuqi; dhe

b) duhet të veprojnë në përputhje me kërkesat që autoriteti kompetent mund të vendosë kur miraton stabilimentet ose kur kryen kontrole në përputhje me legjislacionin në fuqi.

35. Qumështi i trajtuar termikisht duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

1. Qumështi për konsum të përftohet nga qumështi i papërpunuar, i prodhuar në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi dhe që plotëson kërkesat si më poshtë:

a) pastrimi fizik i qumështit të jetë bërë në centrifuga ose pajisje të tjera filtruese të përshtatshme për pastrimin fizik të qumështit;

b) qumështi i lopës të ketë:

i) përmbajtje yndyre jo më të vogël se 3.6 për qind;

ii) pikë ngrirjeje jo më të lartë se -0,520 gradë C. Shmangiet nga kjo pikë ngrirjeje lejohen vetëm në rastet kur nga kontrollet e kryera nuk vërehen shtesa uji në qumështin e papërpunuar;

iii) densitet 1,028 gr/litër, të përcaktuar për qumështin e plotë, në temperaturën 20 gradë C, ose ekuivalente me densitetin e përcaktuar për qumështin plotësisht të skremuar, në 20 gradë C;

iv) përmbajtja e proteinës të jetë jo më pak se 28 gr/litër, e llogaritur duke shumëzuar me 6,38 përmbajtjen e azotit total të qumështit, shprehur në përqindje;

v) përmbajtje të lëndës së thatë, pa yndyrë, jo më pak se 8,5 për qind.

36. Operatorët e biznesit ushqimor që prodhojnë produkte me bazë qumështi duhet të ndërmarrin procedura të tilla që sigurojnë menjëherë përpara përpunimit:

a) që qumështi i papërpunuar i lopëve që përdoret për prodhimin e produkteve me bazë qumështi të ketë përmbajtjen e mikroflorës së përgjithshme në 30°C, më pak se 300 000 për ml; dhe

b) që qumështi i lopëve, që i është nënshtuar më përpara një procesi termik, që përdoret për prodhimin e produkteve me bazë qumështi, të ketë përmbajtjen e mikroflorës së përgjithshme në 30°C, më pak se 100 000 për ml.

37. Kur qumështi nuk përmbush kriteret e përcaktuara në pikën 36, operatori i biznesit ushqimor informon autoritetin kompetent dhe merr masa për të korrigjuar situatën.

38. Pavarësisht nga sa përcaktohet në pikën 36 (a), përmbajtja maksimale e mikroflorës së përgjithshme, për qumështin e lopës së papërpunuar, zbatohet vetëm kur ky qumësht do të trajtohet me nxehtësi dhe nuk i është nënshtuar një trajtimi të tillë, brenda periudhës së dorëzimit, specifikuar në procedurat e aprovuara bazuar në HACCP, të vendosura nga operatorët e biznesit ushqimor.

39. Mbyllja hermetike e ambalazhit duhet të bëhet menjëherë pas mbushjes në stabilimentin përpunues, ku është kryer trajtimi termik i fundit i produkteve të lëngshme me bazë qumështi, me pajisje mbyllëse që parandalojnë kontaminimin. Mbyllja të bëhet në mënyrë të tillë që pas hapjes, shenja e hapjes së tij të jetë e qartë dhe lehtësisht e dallueshme.

40. Përveç kërkesave të përgjithshme për etiketimin, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, etiketimi duhet të përmbajë dhe kërkesat e mëposhtme specifike:

a) në rastin e qumështit të papërpunuar, që do të përdoret direkt për konsum njerëzor, etiketa duhet të përmbajë fjalët “qumësht i papërpunuar”;

b) në rastin e produkteve të prodhuara nga qumësht i papërpunuar, nëpërmjet një procesi prodhimi që nuk përfshin ndonjë trajtim termik ose trajtim fizik ose kimik, fjalët “prodhuar me qumësht të papërpunuar”.

41. Kërkesat e pikës 40 aplikohen për produktet e destinuara për tregtim me pakicë.



PJESA III

KONTROLLI I QUMËSHTIT TË PAPËRPUNUAR DHE PRODUKTEVE ME BAZË QUMËSHTI

1. Kafshët në fermat e prodhimit të qumështit duhet t'u nënshtrohen kontrolleve zyrtare për të verifikuar nëse respektohen kërkesat shëndetësore për prodhimin e qumështit lëndë e parë, dhe në veçanti gjendjes shëndetësore të kafshëve dhe përdorimit të medikamenteve mjekësore veterinarë. Këto kontrolle kryhen sipas legjislacionit në fuqi për kafshët, shëndetin publik ose mirëqenien e kafshëve.

2. Nëse ka vend për dyshime se kërkesat shëndetësore të kafshës nuk respektohen, të kontrollohet gjendja e përgjithshme shëndetësore e kafshës.

3. Stabilimentet e prodhimit dhe të përpunimit të qumështit duhet t'u nënshtrohen kontrolleve zyrtare për të verifikuar nëse kërkesat e higjienës respektohen. Këto kontrolle zyrtare duhet të përfshijnë lokalet, pajisjet, kushtet mjedisore, ambalazhimin, mënyrën e përpunimit, magazinimit dhe nxjerrjes në treg dhe mund të përfshijnë inspektime dhe/ose monitorim të kontrolleve që kryen vetë operatori.

Nëse rezulton që higjiena është e papërshtatshme, autoriteti kompetent duhet të verifikojë nëse janë marrë hapat e përshtatshëm për përmirësimin e situatës.

4. Autoriteti kompetent kryen kontrolle zyrtare të zakonshme sipas programit të mëposhtëm:

a) të paktën një herë në vit në çdo fermë të prodhimit të qumështit, për të kontrolluar nëse respektohen kushtet e përcaktuara në këtë udhëzim për fermat e qumështit;

b) të paktën dy herë në vit në çdo fermë të prodhimit të qumështit, për të kontrolluar se mjelja, grumbullimi dhe transporti i qumështit në pikën e grumbullimit përmbush kërkesat e këtij udhëzimi;

c) gjatë kontrolleve në qendrat e grumbullimit merren mostra të qumështit nga çdo prodhues dhe kontrollohen për:

i) numrin total të mikroorganizmave;

ii) numrin e qelizave somatike;

iii) praninë e brucelozës.

d) të paktën një herë në muaj, merren mostra nga të gjithë prodhuesit në çdo qendër grumbullimi për testin e reduktazës;

e) të paktën katër herë në vit, merren mostra të qumështit dhe produkteve me bazë qumështi nga të gjithë prodhuesit dhe kontrollohen për:

i) numrin total të mikroorganizmave;

ii) numrin total të qelizave somatike;

iii) praninë e brucelozës.

5. Autoriteti kompetent duhet të monitorojë kontrollet e kryera në përputhje me pikat 27, 28, 29, 30, 36, 37 dhe 38.

6. Nëse operatori i biznesit ushqimor nuk ka korrigjuar situatën brenda tre muajve nga njoftimi i parë nga autoriteti kompetent i kontrollit, për mospërputhje me normat në lidhje me përmbajtjen e mikroflorës së përgjithshme dhe përmbajtjen e qelizave somatike, shpërndarja e qumështit të papërpunuar nga ferma e prodhimit të ndërpritet.

Megjithatë autoriteti kompetent mund të autorizojë ose udhëzojë përdorimin e tij në bazë të kërkesave në lidhje me trajtimin dhe përdorimin e tij, të nevojshme për të mbrojtur shëndetin publik. Ky pezullim ose këto kërkesa duhet të mbeten në fuqi deri në momentin që operatori i biznesit ushqimor të ketë faktuar se qumështi lëndë e parë përmbush kriteret e sigurisë.

7. Treguesit e cilësisë për analizimin e testimin e qumështit të trajtuar termikisht janë si më poshtë:

- përmbajtja e lëndës së thatë totale;

- përmbajtja e yndyrës;

- përmbajtja e lëndës së thatë pa yndyrë;

- përmbajtja e proteinës;

- pesha specifike.

8. Treguesit për analizimin dhe testimin e qumështit të papërpunuar janë si më poshtë:
- pika e ngrirjes;
 - përmbajtja e mikroflorës së përgjithshme në 30°C;
 - përmbajtja e qelizave somatike;
 - detektimi i antibiotikëve dhe sulfonamideve.
9. Metodatat analitike të referencës për analizimin dhe testimin e treguesve të përcaktuar në pikat 7 dhe 8 dhe metoda e marrjes së mostrave, janë si më poshtë:
- a) SSH ISO 707:1999 “Metoda e marrjes së mostrave për qumështin dhe produktet me bazë qumështi”;
 - b) Përcaktimi i përmbajtjes së mikroflorës së përgjithshme në 30°C;
Metoda ISO 4833:2003 “Mikrobiologjia e ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë”.
 - c) Përcaktimi i përmbajtjes së qelizave somatike;
Metoda ISO 13366-1: IDF 148-1, duke përdorur mikroskop;
 - d) Përcaktimi i përmbajtjes së lëndës së thatë;
Metoda me tharje: 925.23 (2005) AOAC Bot.18;
 - dh) Përcaktimi i përmbajtjes së lëndës së thatë, pa yndyrë;
Metoda me llogaritje: 990.21 (2005) AOAC Bot.18;
 - e) Përcaktimi i përmbajtjes së yndyrës:
 - I. Metoda Gerber: 2000.18 (2005) AOAC Bot.18;
 - II. Metoda me ekstraktim (Roese-Gottlieb): 905.02 (2005) AOAC Bot.18;
 - III. Metoda me ekstraktim me eter (Mojonnier): 989.05 (2005) AOAC Bot.18;
 - f) Përcaktimi i përmbajtjes së proteinës;
Metoda Klejdahl: 991.20 (2005) AOAC Bot.18;
 - g) Përcaktimi i peshës specifike;
Metoda me hidrometër: 925.22 (2005) AOAC Bot.18;
 - h) Përcaktimi i pikës së ngrirjes
Metoda krioskopike: 920.22 (2005) AOAC Bot.18.
10. Për metodatat analitike të referencës të listuara në pikën 9, të përdoret versioni i fundit i publikuar.

PJESA IV DISPOZITA TË FUNDIT

1. Pikat 28 dhe 36 të pjesës II “Kërkesat specifike në lidhje me fermat e prodhimit të qumështit, qumështit të papërpunuar dhe produkteve me bazë qumështi”, hyjnë në fuqi më 1 janar 2014.
2. Shkeljet e dispozitave të këtij urdhri përbëjnë kundërvajtje administrative dhe trajtohen si të tilla sipas përcaktimit të pikës “gj” të nenit 68 të ligjit nr.9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”.
3. Udhëzimi nr.24, datë 25.11.2010 “Për kërkesat specifike të higjienës në stabilimentet e prodhimit, grumbullimit dhe përpunimit të qumështit dhe produkteve me bazë qumështi”, shfuqizohet.
4. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Sigurisë Ushqimore dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.
Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT DHE
MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Genc Ruli



VENDIM
Nr.5, datë 31.5.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbëra nga:

Shpresa Beçaj	Kryesuese
Gani Dizdari	Anëtar
Ardian Dvorani	Anëtar
Besnik Imeraj	Anëtar
Fatos Lulo	Anëtar
Ardian Nuni	Anëtar
Arjana Fullani	Anëtare
Majlinda Andrea	Anëtare
Guxim Zenelaj	Anëtar
Aleksandër Muskaj	Anëtar
Andi Çeliku	Anëtar
Evelina Qirjako	Anëtare
Mirela Fana	Anëtare
Medi Bici	Anëtar

në seancën gjyqësore të datës 31.5.2011 morën në shqyrtim çështjen civile, që i përket:

PADITËS: Syl Hysaj, në mungesë.

I PADITUR: Kadri Hysa, në mungesë.

OBJEKTI I PADISË: Detyrimin e të paditurit për të më liruar sipërfaqen e truallit prej 80 m².

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 32 të Kodit të Procedurës Civile dhe neni 296 i Kodit Civil.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr.2058, datë 9.11.2005, ka vendosur:

Pranimin e kërkesëpadisë. Detyrimin e të paditurit Kadri Hysa që t'i dorëzojë me shpenzimet e veta paditësit Syl Hysaj sipërfaqen prej 70.7 m² të ndodhur në pasurinë nr.240/3, ndodhur në zonën kadastrale nr.2749, në fshatin Myselim.

Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr.181, datë 23.4.2007, ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr.2058, datë 9.11.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe rrëzimin e kërkesëpadisë.

Kundër vendimit nr.181, datë 23.4.2007 të Gjykatës së Apelit Shkodër ka ushtruar rekurs paditësi Syl Hysaj, duke kërkuar prishjen e vendimit nr.181, datë 23.4.2007 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe lënien në fuqi të vendimit nr.2058, datë 9.11.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për këto shkaqe:

- Vendimi i gjykatës së apelit është i pambështetur në prova dhe në ligj.

- Nga shqyrtimi gjyqësor ka rezultuar se paditësi është pronar i sipërfaqes së truallit, pronësi të cilën e ka fituar në bazë të ligjit nr.7501; këtë pronë paditësi e ka regjistruar në ZRPP në datë 20.11.2003 me nr.111, si dhe ka rezultuar e provuar se në këtë sipërfaqe, pa asnjë tagër ligjore, ka ndërnuar pa leje ndërtimi i paditurit.

- Duke qenë se në këtë moment nuk jemi njohur me vendimin e arsyetuar të gjykatës së apelit, rezervojmë të drejtën që të paraqesim shkaqet e plota për kundërshtimin e këtij vendimi.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.Regj. Themeltar 01363/07, datë 6.5.2010, ka vendosur:

Kalimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara për unifikimin e praktikës gjyqësore.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relativimin e çështjes nga gjyqtarët Arjana Fullani dhe Guxim Zenelaj; dhe pasi e biseduan çështjen në tërësi,

VËREJNË:

Rrethanat e çështjes

1. Nga shqyrtimi i akteve në dosje rezulton se paditësi Syl Hysaj i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi në vitin 2005, me anë të së cilës ka kërkuar të detyrohet i padituri Kadri Hysa për të liruar sipërfaqen e truallit prej 80 m², të cilën ia ka zënë me ndërtim. Në mbështetje të kërkesëpadisë, paditësi ka paraqitur prova shkresore, si aktin nr.111 të marrjes së tokës në pronësi dhe certifikatën datë 20.11.2003 për vërtetimin e pronësisë së lëshuar nga ZVRPP-ja Shkodër.

2. Në prapësim të padisë, i padituri Kadri Hysa ka paraqitur një deklaratë dore për shitje toke truall, ku shitës figuron paditësi Syl Hysaj dhe blerës i padituri Kadri Hysa, me anë të së cilës ka pretenduar se është në kushtet e fitimit të pronësisë së tokës në fjalë me parashkrim fitues, në bazë të nenit 168 të Kodit Civil.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr.2058, datë 9.11.2005, ka pranuar kërkesëpadinë duke detyruar të paditurin Kadri Hysa që t'i dorëzojë me shpenzimet e veta paditësit Syl Hysaj sipërfaqen prej 70.7 m² të ndodhur në pasurinë nr.240/3, ndodhur në zonën kadastrale nr.2749, në fshatin Myselim.

3.1. Në pranimin e padisë, gjykata arsyeton: *“Për sa i përket vlerësimit të fuqisë provuese të deklaratës së paraqitur nga i padituri Kadri, gjykata mban parasysh faktin që në deklaratë data dhe shkrimi i saj kanë ndryshime pasi dallohet qartë që nuk janë shkruar në të njëjtin moment (sepse ndryshon boja e shkrimit), fakti që nënshkrimi i saj u kundërshtua nga paditësi dhe nga ana e të paditurit nuk u provua origjinaliteti i kësaj deklaratë. Duke marrë në tërësinë e tyre këto rrethana, gjykata çmon se kjo deklaratë nuk ka fuqi provuese për të provuar faktin që nga pala paditëse t'i jetë shitur të paditurit në vitin 1994 sipërfaqja objekt konflikti.*

Pretendimi tjetër i të paditurit Kadri, se ka mospërputhje midis sipërfaqes së paraqitur në certifikatën e pronësisë, ku prona e paditësit rezulton që të ketë një sipërfaqe prej 1700 m² me sipërfaqen që rezulton nga akti i marrjes së tokës në pronësi, ku sipërfaqja rezulton që të jetë 1200 m², nuk merret parasysh nga gjykata pasi vetë i padituri nuk kundërshton pronësinë e paditësit Syl, por pretendon që sipërfaqen objekt konflikti e ka fituar me parashkrim fitues me titull që rrjedh nga paditësi Syl Hysaj ... Paditësi Syl Hysaj provon që është pronar i kësaj sipërfaqeje, fakt ky që provohet nga certifikata e pronësisë ... nr.240/3 ... i padituri sipërfaqen në fjalë e mban pa asnjë titull ...”.

4. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr.181, datë 23.4.2007, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka rrëzuar padinë.

4.1. Në ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, gjykata e apelit arsyeton: *“Paditësi Syl pohoi para trupit gjykues ... se i padituri ia ka zënë truallin me ndërtim në vitin 1994. Kjo do të thotë se paditësi Syl e ka humbur posedimin e truallit që kërkon t'i kthehet që në vitin 1994. Në maj të vitit 2005 kur paditësi i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi, kishin kaluar 10 vjet që ai kishte humbur posedimin e truallit ku i padituri kishte ndërtuar dyqanin qysh në vitin 1994... paditësit Syl Hysaj i është shuar e drejta e padisë për kërkimin e sendit bazuar në nenin 296 të KC-së dhe nuk mund ta realizojë me anë të gjykatës (neni 112 i KC-së). Trupi gjykues ... nuk e gjen të bazuar pretendimin e paditësit Syl Hysaj se afati i parashkrimit të padisë fillon nga data, që ai ka regjistruar tokën në ZRPP Shkodër” 20.11.2003.*

5. Kundër vendimit nr.181, datë 23.4.2007 të Gjykatës së Apelit Shkodër ka ushtruar rekurs paditësi Syl Hysaj, duke kërkuar prishjen e vendimit nr.181, datë 23.4.2007 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe lënien në fuqi të vendimit nr.2058, datë 9.11.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.Regj. Themeltar 01363/07, datë 6.5.2010, ka vendosur: *“Kalimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara për unifikimin e praktikës gjyqësore”.*



6.1. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pasi citon nenet 112, 113, 114, 119, 168, 191 dhe 349 të Kodit Civil, parashtron: *Në vështrim të neneve të përmendura më sipër, si dhe të gjitha rregullave të tjera të përgjithshme të parashikuara në Kreun I të KC-së “Mbi parashkrimin e padisë ...”, ashtu dhe në titullin VII të KC-së “Mbi mbrojtjen e pronësisë”, si dhe qëndrimit të mbajtur nga doktrina se padia e rivendikimit i nënshtrohet parashkrimit shues si çdo padi tjetër me karakter pasuror sipas rregullave të përgjithshme të KC-së, apo që padia e rivendikimit dhe padia mohuese kanë karakter real, janë padi reale, në kuptimin që ato megjithëse drejtohen kundër personit (cenuesit), kanë për objekt të drejtpërdrejtë sendin, d.m.th. ekzekutimi në këto padi synon drejtpërsëdrejti sendin në duart e cilitdo që të ndodhet, ka praktikë të pa unifikuar në raport me këtë çështje.*

Ka praktikë të Gjykatës së Lartë që një parashkrimin shues për padinë e rivendikimit. Bazuar në këtë qëndrim janë rrëzuar paditë e rivendikimit si të parashkruara meqë ka kaluar afati 10-vjeçar i përcaktuar në ligj.

Ka po kështu edhe vendime të tjera që e pranojnë se padia e rivendikimit nuk parashkruhet, por këto vendime përgjithësisht nuk e kanë të arsyetuar këtë qëndrim.

Ky Kolegj vëren se në rrethanat konkrete të çështjes në shqyrtim, në funksion të zgjidhjes së saj, si dhe duke u nisur nga fakti që në praktikën tonë gjyqësore mbahen qëndrime të ndryshme dhe të kundërta në lidhje me këtë çështje, është vendi për të bërë një interpretim të drejtë të normave të Kodit Civil lidhur me parashkrimin e padisë së kërimit të sendit.

Nisur nga sa më sipër, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë çmon se është vendi për të kaluar çështjen për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara për njësimin e praktikës gjyqësore, duke shtruar për zgjidhje këtë problem:

“Duke u nisur nga natyra e padisë së rivendikimit, si dhe nga karakteristikat e veçanta të së drejtës së pronësisë, a është padia e rivendikimit një padi e parashkrueshme apo jo?”

Ligji i zbatueshëm

7. Dispozitat e Kodit Civil, në të cilat është parashikuar:

7.1. Neni 112 i Kodit Civil: *“E drejta e padisë që nuk është ushtruar brenda afatit të caktuar në ligj, shuhet dhe nuk mund të realizohet më me anë të gjykatës ose të organit tjetër kompetent”.*

7.2. Neni 113§1 i Kodit Civil: *“Nuk parashkruhen: a) Padia për rivendosjen ose mbrojtjen e një të drejte vetjake jo pasurore, përveç përjashtimeve të caktuara në ligj; b) Paditë e njohjes; c) Padia e pjesëtimit midis bashkëpronarëve; d) Padia për kthimin e shumave të depozituara në bankë; e) Paditë e tjera të parashikuara në dispozita ligjore të veçanta”.*

7.3. Neni 114 i Kodit Civil: *“Kur në ligj nuk është parashikuar ndryshe, parashkruhen brenda dhjetë vjetëve të gjitha paditë midis personave juridikë, midis këtyre dhe personave fizikë, si dhe midis vetë personave fizikë”.*

7.4. Neni 119 i Kodit Civil: *“Për kërkimin e sendit parashkrimi i padisë fillon nga dita kur pronari ka marrë ose duhej të merrte dijeni për cenimin dhe cenuesin e të drejtës së tij”.*

7.5. Neni 140 i Kodit Civil: *“Afatit prekluziv i plotësuar merret parasysh nga gjykata ose arbitrazhi kompetent me nismën e vet, edhe pa u kërkuar nga pala e interesuar”.*

7.6. Neni 149 i Kodit Civil: *“Pronësia është e drejta për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufijve të caktuar nga ligji”.*

7.7. Neni 168 i Kodit Civil: *“Personi që ka fituar me mirëbesim një send, në bazë të një veprimi juridik për kalimin e pronësisë dhe që nuk është i ndaluar nga ligji, bëhet pronar i këtij sendi pas një posedimi të pandërprerë prej pesë vjetësh kur sendi është i luajtshëm dhe prej dhjetë vjetësh kur ai është i paluajtshëm.*

Kur posedimi nuk është me mirëbesim, afatet e posedimit të pandërprerë dyfishohen. Posedimi konsiderohet i pandërprerë edhe kur fituesi i sendit ia ka dhënë posedimin një personi tjetër.

Nuk mund të fitohet me parashkrim fitues një send që është pronë publike e patjetërsueshme”.

7.8. Neni 169 i Kodit Civil: *“Personi që ka poseduar qetësisht e pandërprerë, duke u sjellë sikur të ishte pronar për njëzet vjet në një pronë të paluajtshme, bëhet pronar i saj”.*

7.9. Neni 296 i Kodit Civil: *“Pronari ka të drejtë të ngrejë padi për të kërkuar sendin e tij nga çdo posedues ose mbajtës. Këtë të drejtë e ka edhe çdo bashkëpronar për sendin e përbashkët, me qëllim që ai t'u dorëzohet gjithë bashkëpronarëve”.*

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës të Lartë vlerësojnë:

8. Se për zgjidhjen e çështjes, nëse padia e rivendikimit i nënshtrohet ose jo parashkrimit shues, krahas dispozitave të Kodit Civil që rregullojnë të drejtën e pronësisë dhe institutet e tjera që lidhen me këtë të drejtë, të marrin në konsideratë:

i) Karakteristikat, natyrën juridike dhe rëndësinë e pronësisë si marrëdhënie shoqërore, si dhe veçoritë e sjelljes së personave ndaj sendeve objekt pronësie;

ii) kuptimin dhe veçoritë e padisë si mjete kryesor për mbrojtjen dhe rivendosjen gjyqësisht të të drejtave civile të shkelura;

iii) kuptimin, elementët dhe karakteristikat thelbësore të institutit të parashkrimit shues; të përbashkëtat dhe dallimet midis këtij instituti dhe instituteve të parashkrimit fitues dhe prekluzivitetit, si dhe fushën e zbatimit të tyre; (iv) traditën juridike shqiptare në lidhje me këto institute.

9. Pronësia është një institut qendror i së drejtës civile. Nga ana tjetër, e drejta e pronësisë është një nga të drejtat themelore, të garantuara në dispozitat kushtetuese dhe në aktet ndërkombëtare të pranuar nga shteti shqiptar.

10. Karakteri dhe përmbajtja e së drejtës së pronësisë në kuptimin juridiko-civil është sanksionuar në nenin 149 të Kodit Civil, sipas të cilit *“Pronësia është e drejta për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufijve të caktuar nga ligji”.* Nga kjo dispozitë, si dhe nga përmbajtja e neneve 296, 302, 304 të Kodit Civil rezulton se posedimi, gëzimi dhe disponimi janë tre tagrat (pushtetet) kryesore të pronarit.

11. Ligji detyron të gjithë të tretët të mos kryejnë veprime të cilat cenojnë tagrat e pronarit, pra që pengojnë pronarin në ushtrimin e lirë të posedimit, gëzimit dhe disponimit mbi sendet e tij.

12. Pronësia si e drejtë subjektive ka karakter: **pasuror, absolut, real, të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm**. Objekt i së drejtës së pronësisë janë sendet. Mbajtësi i së drejtës së pronësisë ka si të detyruar një numër të pakufizuar personash dhe e realizon të drejtën e tij pa ndërmjetësinë e personave të tjerë dhe ka të drejtë të kërkojë sendin nga çdo posedues apo mbajtës i paligjshëm, qoftë ai dhe me mirëbesim. E drejta e pronësisë nuk ka mbarim në kohë, nuk merr fund me kalimin e një afati të caktuar, pronari në mënyrë të vazhdueshme dhe të përhershme realizon të drejtën e tij të pronësisë mbi sendin duke gëzuar dhe disponuar lirisht atë, brenda kufijve të caktuar nga ligji. Gjithashtu, e drejta e pronësisë e pronarit mbi sendin është e pavarur nga të tretët. Vullneti i të tretëve nuk ka rëndësi për pronarin.

13. Kur pushtetet që pronari ka mbi sendin i kundërshtohen apo i cenohen nga të tretët, tërësisht apo pjesërisht, ligji i ka njohur pronarit të drejtën për të përdorur mjetet e mbrojtjes, midis të cilëve kryesori është padia.

14. Në vlerësim të së drejtës së padisë në kuptimin material, paraprkishtë Kolegjet e Bashkuara evidentojnë se padia është mjet juridik për mbrojtjen e së drejtës subjektive dhe si e tillë nuk duhet ngatërruar me vetë të drejtën subjektive. Padia është garanci ligjore për mbrojtjen e së drejtës subjektive. E drejta e padisë në kuptimin material është një e drejtë që i jepet mbajtësit të së drejtës subjektive që, në rast cenimi ose mohimi të kësaj të drejte, të rivendosë atë duke iu drejtuar gjykatës.

15. Në teorinë e së drejtës civile është pranuar se e drejta subjektive *“...është mundësia juridike e mbajtësit të së drejtës subjektive për të kryer vetë veprime të caktuara, si dhe mundësia për të kërkuar nga personi i detyruar kryerjen ose moskryerjen e veprimeve të caktuara, mundësi kjo e garantuar me mundësinë për të kërkuar, në rast nevojë, mbrojtje shtetërore, me qëllim që mbajtësi i së drejtës subjektive të kënaqë interesat e tij të ligjshme”.*

15.1. Rastet e humbjes të së drejtës subjektive janë të përcaktuara shprehimisht në ligj.

16. Për rastin në shqyrtim, Kolegjet e Bashkuara do të kufizohen vetëm në padinë e rivendikimit apo të kërkimit të sendit (*actio rei vindicatio*), parashikuar nga neni 296 i Kodit Civil.

16.1. Në thelb, padia e rivendikimit është padia e pronarit jo posedues ndaj poseduesit jo pronar. Kjo padi ka për qëllim: a) njohjen e së drejtës së pronësisë të paditësit mbi sendin e rivendikuar; dhe b) detyrimin e të paditurit t'i kthejë paditësit sendin e rivendikuar.



16.2. Njohja e pronësisë së paditësit është kusht i domosdoshëm për pranimin e kërimit të paditësit. Karakteri njohës i kësaj padie rezulton nga vetë natyra e saj. Ky karakter i përgjigjet padisë së njohjes (pozitive), që sipas nenit 113/b të Kodit Civil nuk i nënshtrohet parashkrimit.

16.3. Padia e rivendikimit është padi reale dhe me të mbrohet e drejta e pronësisë mbi sendet individualisht të përcaktuara, qofshin të paluajtshme apo të luajtshme.

17. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes nëse kjo padi i nënshtrohet ose jo parashkrimit shues, paraprakisht parashtrijmë se:

17.1. Në nenin 112 të Kodit Civil parashikohet se: *“E drejta e padisë që nuk është ushtruar brenda afatit të caktuar në ligj, shuhet dhe nuk mund të realizohet me anë të gjykatës ose të organit tjetër kompetent”*.

17.2. Nga përkufizimi i dhënë në këtë dispozitë del në pah natyra juridike e institutit të parashkrimit, funksionet e tij, duke u dhënë në mënyrë sintetike karakteristikat e përgjithshme dhe kushtet thelbësore të parashkrimit shues.

18. Në zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi, argumenti ligjor i Kolegjeve të Bashkuara do të ketë si pikënisje këtë përkufizim. Nga përmbajtja e kësaj dispozite tregohet se parashkrimi i padisë përmban kurdoherë dy kushte ose elemente thelbësore: a) kalimin e një periudhe kohe të caktuar dhe b) mosveprimin e titullarit për të ushtruar këtë të drejtë gjatë kësaj kohe. Kushti i parë përbën atë që quhet afat i parashkrimit të padisë dhe kushti tjetër konsiston në mosveprimin e titullarit të së drejtës në rastet kur ai mund dhe duhej të vepronte.

19. Elementi thelbësor i parashkrimit nuk është kalimi i kohës në vetvete, por është mosveprimi/pasiviteti i titullarit të së drejtës për të mbrojtur, brenda kohës së caktuar nga ligji, të drejtën e tij të cenuar ose të mohuar.

20. Qëndrimi jokonseguent i jurisprudencës në lidhje me parashkrimin ose jo të padisë së rivendikimit janë rrjedhojë e mungesës së një dispozite konkrete në legjisllacionin tonë, e cila në mënyrë të shprehur të përcaktonte karakterin e paparashkrueshëm të padisë së kthimit të sendit.

21. Por, mungesa e një dispozite konkrete në lidhje me parashkrimin ose jo të padisë së rivendikimit nuk do të thotë *a priori* se kjo padi, referuar nenit 114 të Kodit Civil, është e parashkrueshme.

22. Në pranimin ose jo të parashkrimit të kësaj padie duhen parë në harmoni tërësia e dispozitave ekzistuese të Kodit Civil dhe karakteristikat që përmban e drejta e pronësisë, rëndësia që ka e drejta e pronësisë, natyra e saj ekonomike dhe juridike.

23. **Arsyet e paparashkrueshmërisë të kësaj padie gjenden në vetë natyrën juridike të pronësisë.** Kjo, e parë në harmoni dhe me institutin e parashkrimit shues dhe fitues, dhe veçanërisht me prekluzivitetin që, është pranuar si institut më vete në legjisllacionin tonë.

24. Duke mënjeluar qëndrimet e ndryshme në lidhje me debatin nëse ka kategori të drejtash që nuk i nënshtrohen parashkrimit shues apo ka vetëm shkaqe parashkrimi që mund të kenë vend si në kategorinë e të drejtave pasurore ashtu dhe në kategorinë e të drejtave personale, Kolegjet e Bashkuara e gjejnë me vend të parashtrijnë se kriteri kryesor dhe i pa kundërshtuar për kategorizimin e të drejtave është përmbajtja e tyre; janë veçoritë e përbashkëta të një grupi të drejtash që i dallojnë ato nga një grup tjetër të drejtash, të cilat kanë gjithashtu tipare të përbashkëta por të ndryshme nga ato të parat.

24.1. Kështu, përmbajtja e një kategorie të drejtash, me qëllim që t’u shërbehet më mirë interesave socialë dhe individualë, lejon dhe kërkon, si rregull, veprimin e parashkrimit, ndërsa përmbajtja e një tjetre përgjithësisht nuk e lejon, përveç kur interesat e qëndrueshmërisë së një marrëdhënieje juridike kërkojnë që ndonjëra nga të drejtat e kësaj kategorie të ushtrohet brenda afatit të caktuar nga ligji, brenda afatit të parashkrimit.

24.2. Ka dy lloje padish që nuk parashkruhen: a) Ato për të cilat ligji thotë që nuk parashkruhen; b) ato padi që nga natyra e tyre nuk e pranojnë parashkrimin. Shembull tipik i rastit të dytë, për të cilin praktika gjyqësore ka qenë konsekuente, është rasti i padisë mohuese e cila, ndonëse nuk përmendet askund në ligj si padi që nuk parashkruhet, pranohet prej të gjithëve si e paparashkrueshme për shkak të natyrës së saj.

24.3. Paparashkrueshmëria e së drejtës së padisë për kërkime pasurore përbën përjashtimet nga rregulli (neni 113 i Kodit Civil), një ndër të cilat, pavarësisht se nuk gjendet shprehimisht në ligj, është dhe padia e rivendikimit.

25. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se mosushtrimi i padisë për të mbrojtur një të drejtë nuk duhet njësuar me mosushtrimin e të drejtës së përdorimit të sendit. Mungesa e ushtrimit të së drejtës së përdorimit të sendit nga titullari mund të krijojë rrethana që një person tjetër të fitojë në mënyrë origjinare pronësinë mbi këtë send, por jo të passjellë shuarjen e së drejtës së padisë.

25.1. Mospërdorimi i sendit nga pronari është shprehje e lirisë që i njihet atij, është një manifestim i gjerësisë së tagrave që i përkasin pronarit.

25.2. Edhe nëse sendi objekt pronësie nuk përdoret, ky mospërdorim është një manifestim i vullnetit të pronarit. Pra, edhe mospërdorimi i sendit është pjesë e tagrave të pronarit. Ndërkohë, parashkrimi i padisë ka si qëllim realizimin e një interesi të caktuar: çlirimin e debitorit nga detyrime të vjetra, shpeshherë të harruara apo shumë të vështira për t'u provuar, çka nuk është rilevante për të drejtën e pronësisë, për shkak të karakteristikave të saj të përmendura më sipër.

25.3. Për nga karakteri, parashkrimi i shtrin efektet e veta kryesisht në një marrëdhënie juridike dypalëshe relative, ku në fakt një subjekt mund të favorizohet duke mos u detyruar forcërisht ta përmbushë atë. Instituti i parashkrimit është vendosur në favor të debitorit, për ta mbrojtur atë nga paditë e vjetra dhe vështirësitë e të provuarit.

25.4. E ndryshme është situata në rastin e pronësisë. Pronësia, si marrëdhënie absolute, është e drejtuar *erga omnes* dhe në këtë marrëdhënie nuk qëndron një “*i kundër-interesuar*” (me përjashtim të rastit të parashkrimit fitues), një subjekt që mund të favorizohet nga parashkrimi.

Nëse do të pranohet që padia e rivendikimit parashkruhet, mund të vendoseshim para situatës kur pronari (i njohur si i tillë) të mos kishte mundësi të ushtronte të drejtat e tij mbi sendin për shkak të kalimit të afatit, ndërsa poseduesit të sendit (i paligjshëm dhe madje edhe në keqbesim) do t'i krijohej mundësia për ta gëzuar i qetë sendin, i pashqetësuar nga pronari, i cili, sikurse thamë, do të ishte në pamundësi për të vepruar për shkak të kalimit të afatit të parashkrimit shues. Madje, në këtë mënyrë poseduesit të paligjshëm do t'i krijohej, në mënyrë absurde, edhe mundësia për t'u bërë pronar i sendit me kalimin e afateve të parashkrimit fitues pa titull (neni 169 i Kodit Civil).

E drejta, e interpretuar në këtë mënyrë, do të dilte jashtë qëllimit të saj, do të çonte në pasoja që vijnë ndesh me vetë funksionin e saj.

Është e qartë, pra, që interpretimi i së drejtës (normës, parimit, institutit, etj.) duhet bërë në përputhje me qëllimin e së drejtës dhe në përmbushjen e funksioneve bazë të saj [siç është siguria dhe drejtësia].

26. Pavarësisht se nuk ka ndonjë normë juridike ku të jetë formuluar shprehimisht se padia e rivendikimit është e paparashkrueshme, sikurse është parashikuar në legjisllacionin francez¹ dhe në atë italian² apo për padinë e kërkimit të trashëgimit³, në vështrim të tërësisë së dispozitave që rregullojnë pronësinë dhe institute të tjera të së drejtës civile dhe faktorëve që formësojnë përmbajtjen e tyre, nuk mund të pranohet se kjo padi është e paparashkrueshme.

27. Në literaturën juridike civile dhe në jurisprudencën, pas miratimit të Kodit Civil të vitit 1929, në interpretim të nenit 2034 të këtij Kodi, ka qenë pranuar dallimi midis të drejtës së zotnimit (të drejtës së pronësisë) dhe të drejtave të tjera reale në lidhje me parashkrimin shues.⁴

27.1. Sipas kësaj praktike të drejtat e tjera reale, që njihen si *iura in re aliena* (të drejtat e të tjerëve mbi një send të huaj), përveç të drejtës së pronësisë, mund të humbasin me parashkrim shues. Kjo për shkak se të drejtat reale që kufizojnë të drejtën e pronësisë janë në kundërshtim me gjendjen normale të pronësisë, e cila normalisht duhet të jetë e pakufizuar dhe ekskluzive.

¹ Neni 2227 i Kodit Civil Francez

² Neni 948§3 i Kodit Civil Italian

³ Neni 351 i Kodit Civil Shqiptar, viti 1994

⁴ Baltasar Benusi “Komentari i Kodit Civil: Sendet, Zotërimi dhe Modifikimet e tija” faqe 88



27.2. Sipas nenit 2034 të Kodit Civil të vitit 1929, të drejtat reale mbi sendin e tjetrit (usufrukti, servituti) shuheshin me kalimin e 30 vjetëve. Por nuk mund të bëhet i njëjti arsyetim edhe për të drejtën e pronësisë, kur pronari e ka lënë pronën në dorë të një personi tjetër për një kohë të gjatë. Në këto raste, pronari mund të humbasë pronësinë e vet vetëm për shkak se personi tjetër fiton të drejtën e pronësisë mbi pronën me parashkrim fitues. Kjo për arsye se e **drejta e pronësisë nuk mund të humbasë nga mospërdorimi, edhe sikur pronari të mos ta ketë përdorur sendin e vet për një kohë të gjatë. Pronari nuk e humbet të drejtën e ushtrimit të padisë së rivendikimit derisa i padituri nuk e ka fituar pronësinë me parashkrim fitues.**

28. I njëjti qëndrim ligjor mbahet dhe në Kodin Civil në fuqi. Të drejtat reale mbi sendin e tjetrit mund të humbasin me parashkrim shues.¹

29. Në vijim të argumentit të mësipërm dhe në referencë të legjislacionit civil në fuqi, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se paparashkrueshmëria e padisë së rivendikimit buron nga karakteri i përhershëm dhe i qëndrueshëm i pronësisë, që do të thotë se pronësia mbetet e tillë edhe kur ndodhet në posedimin e çdo personi të tretë, që nuk e ka fituar pronësinë nëpërmjet veprimeve juridike të tjetërsimit apo me ndonjë mënyrë tjetër të ligjshme.

30. Në një vështrim krahasues dhe interpretim të dispozitave mbi parashkrimin dhe disa instituteve të tjera të së drejtës civile, Kolegjet e Bashkuara evidentojnë se:

30.1. Mënyrat e fitimit të pronësisë janë njëkohësisht dhe mënyra të humbjes së pronësisë. Kjo situatë nuk duhet konfunduar me situatën kur është plotësuar afati i parashkrimit shues për padi të caktuara.

30.2. Parashkrimi fitues (me titull ose pa titull) është një nga mënyrat e fitimit të pronësisë, parashikuar në nenet 168 dhe 169 të Kodit Civil. Nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara në këto dispozita, padia e rivendikimit rrëzohet, **jo për shkak të parashkrimit shues, por pasi kjo mënyrë fitimi pronësie përbën shkakun ligjor që pronari i mëparshëm i sendit humbet të drejtën e tij të pronësisë mbi sendin.**

30.3. Edhe në rastet kur një person nuk e përdor sendin për një periudhë mbi 20 vjet dhe pronësinë mbi këtë send e fiton një person tjetër për shkak të plotësimit të kushteve të përcaktuara në nenin 169 të Kodit Civil, personi i parë e ka humbur pronësinë e tij mbi sendin jo për shkak të parashkrimit shues, ose për shkak të mospërdorimit të sendit mbi 20 vjet, por për shkak se pronësinë mbi këtë send e ka fituar personi tjetër me anë të parashkrimit fitues.

31. Në argumentim sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se në raste të tilla **nuk është parashkrimi i së drejtës së padisë shkak i rrëzimit të padisë, por është fakti se paditësi ka humbur të drejtën e tij të pronësisë për shkak se i padituri ka fituar të drejtën e pronësisë mbi sendin me parashkrim fitues.**

32. Në zgjidhje të drejtë të çështjes në shqyrtim nuk mund të anashkalohet dhe padia mohuese (*actio negatoria*), parashikuar nga neni 302 i Kodit Civil.

32.1. Në legjislacionin civil, sikurse kemi përmendur edhe më sipër, nuk ka ndonjë dispozitë ligjore ku të jetë përmendur se padia mohuese nuk parashkruhet, por kjo del nga vetë natyra e saj. Edhe kjo padi është padi reale dhe ka për qëllim të mbrojë tagrat e pronarit (posedues) dhe bazohet në një cenim me karakter vazhdues.

32.2. Rregulli i pranuar për padinë mohuese si padi e paparashkrueshme gjen zbatim *mutatis mutandis* edhe për padinë e rivendikimit. Nisur nga fakti se padia e rivendikimit synon të mbrojë pronësinë në tërësi, tagrat e pronarit, ndër të cilat atë të posedimit që i është hequr pronarit dhe, sado e largët që të jetë koha që ka filluar cenimi i kësaj tagre, derisa ky cenim vazhdon, kjo padi mund të ngrihet në çdo kohë sepse as që mund të bëhet fjalë për parashkrimin e saj, për shuarjen e së drejtës së pronësisë.

33. Prirja e pronësisë për të mos u kufizuar në kohë nga mos përdorimi i sendit, ka ngjashmëri, duke mos u njësuar plotësisht, dhe me përcaktimet e bëra në nenin 351 të Kodit Civil ku është

¹ Neni 293/b i Kodit Civil: “Servitutet shuhen...b) Kur nuk përdoret për më shumë se dhjetë vjet”.

parashikuar se: *“Padia për kërkimin e trashëgimit nuk parashkruhet, përveç efekteve të parashkrimit fitues për sende të veçuara”*.

33.1. Mbajmë parasysh këtu se padia e kërkimit të trashëgimit, kur objekt kërkimi janë sende të individualizuara, është shumë e ngjashme dhe ka të gjitha karakteristikat e padisë së kthimit të sendit. Dallimet ekzistojnë vetëm në kërkesat për t’u legjitimuar aktivisht (paditësi duhet të jetë pronar me titull trashëgimor) dhe pasivisht (i padituri duhet të mbajë sendin si trashëgimtar, por pa qenë i tillë).

Në gjithçka tjetër bëhet fjalë për kthimin e sendit nga poseduesi jo pronar (trashëgimtari aparent) tek pronari jo posedues (pronari me titull trashëgimor).

34. Në argument të këtij opinioni ligjor është dhe parashikimi në legjislacionin tonë civil i prekluzivitetit (dekadencës së të drejtave).¹ Pranimi i prekluzivitetit si institut i mëvetësuar nga parashkrimi shues konsolidon qëndrimin se e drejta subjektive nuk shuhet me plotësimin e afatit të parashkrimit, parashikuar nga neni 114 i Kodit Civil.

34.1. Ndryshe nga legjislacioni civil, dhe qëndrimi i mbajtur nga teoria dhe jurisprudenca e mëparshme, me përfshirjen e këtij instituti të së drejtës në Kodin Civil dallohet përfundimisht efekti juridik i parashkrimit si shues i së drejtës së padisë me efektin juridik të prekluzivitetit si shues i së drejtës subjektive.

34.2. Prekluziviteti shuan të drejtën subjektive të personit, ai nuk i referohet të drejtës së padisë. Situata ngatërrohet për shkak se me humbjen e së drejtës subjektive, nuk mund të ngrihet padi për një të drejtë që nuk ekziston më, ose po u ngrit kjo padi rrëzohet. Ndërsa, në qoftë se i referohemi parashkrimit të padisë, ky është një institut (fakt juridik me pasoja shuese), që i referohet në mënyrë strikte humbjes të së drejtës së padisë dhe nuk ka të bëjë me të drejtën subjektive si të tillë. Madje, referuar rregullimit të nenit 125 të Kodit Civil, që afati i kaluar i parashkrimit të sjellë pasojën, pra humbjen e së drejtës së padisë, ai duhet, që gjithashtu të jetë i shoqëruar dhe me pretendimin e kalimit të këtij afati nga pala në favor të së cilës është vendosur ky afat.

35. Në lidhje me nenin 119 të Kodit Civil, Kolegjet e Bashkuara nuk konstatojnë kundërshti midis kësaj dispozite dhe paparashkrueshmërisë së padisë së kthimit të sendit. Në këtë dispozitë përcaktohet momenti i fillimit të ecjes së parashkrimit të padisë për kërkimin e sendit, që përkon me ditën *“kur pronari ka marrë ose duhej të merrte dijeni për cenimin dhe cenesin e së drejtës së tij”*. Ekzistenca e një dispozite të përgjithshme me këtë formulim nuk do të thotë *a priori* se padia e kërkimit të sendit është e parashkrueshme. Sikundër u argumentua më lart në rastin e kësaj padie kjo dispozitë nuk gjen zbatim. Gjithashtu, i njëjti formulim konstatohet edhe në nenin 122 të Kodit Civil, por padia e kërkimit të trashëgimit nuk i nënshtrohet afateve të parashkrimit shues, përveç efekteve të parashkrimit fitues për sende të veçuara (neni 351 i Kodit Civil).

36. Në argument të këtyre konkluzioneve, Kolegjet e Bashkuara ritheksojnë:

i) e drejta e pronësisë është një e drejtë absolute, e pakufizuar në kohë dhe ushtrohet nga titullari në çdo kohë. Të pranosh që e drejta e pronësisë humbet me anë të parashkrimit shues, do të thotë që ushtrimin të kësaj të drejte t’i vësh kufij kohorë dhe ta kufizosh të drejtën e pronarit me kufij të caktuar kohorë, gjë që do të vinte në kundërshtim me konceptin e vetë të drejtës së pronësisë.

ii) E drejta e pronësisë është një e drejtë me karakter të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm, çka do të thotë se ajo ekziston në çdo kohë dhe mosgëzimi i sendit nga pronari apo mosushtrimi i kësaj të drejte për një periudhë të caktuar nga pronari, pavarësisht nga periudha, nuk sjell shuarjen e të drejtës së pronësisë.

iii) një argument i vlerësueshëm që pronësia nuk shuhet me anë të parashkrimit shues është dallimi midis këtij instituti, si fakt juridik i kategorisë së ngjarjeve, i cili sjell humbjen e së drejtës së padisë dhe parashkrimit fitues si mënyrë e fitimit të pronësisë. Parashkrimi fitues në kushtet e përcaktuara në ligj mund të sjellë lindjen ose fitimin e së drejtës së pronësisë, ndërsa parashkrimi shues për asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk mund të sjellë humbjen e së drejtës së pronësisë, sepse ai është lidhur ngushtë (në fushën e së drejtës civile) me humbjen e të drejtës së padisë dhe jo me humbjen e së drejtës së pronësisë (me të drejtën subjektive).

¹ Nenet 137-140 të Kodit Civil



37. Sikundër më sipër, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se paparashkrueshmëria e padisë së rivendikimit ka kuptimin që ajo mund të ngrihet kurdoherë, pavarësisht nga periudha që ka kaluar që nga çasti kur pronari i sendit nuk e ushtron posedimin mbi të, dhe aq kohë sa e drejta e pronësisë mbi këtë send të mos ketë kaluar për ndonjë shkak tjetër ligjor tek ndonjë subjekt tjetër, si në rastin e parashkrimit fitues. Referuar çështjes, dhe për nevojat e zgjidhjes së saj, mjaftohemi me konstatimin e qenies së një mundësie të tillë, duke mos i hyrë diskutimit të kushteve që duhet të plotësohen për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues me titull apo pa titull.

37.1. Paparashkrueshmëria e padisë së rivendikimit, gjithashtu, e ka burimin në faktin se pushteti që përbën elementin bazë të së drejtës subjektive të pronësisë, ashtu siç është përkufizuar kjo e drejtë në nenin 149 të Kodit Civil përjashton çdo pushtet të njëjtë me këtë që ka për objekt të njëjtin send.

38. Këto arsye janë plotësisht të mjaftueshme për të vlerësuar se padia e rivendikimit nuk i nënshtrohet parashkrimit shues. “*Da lege lata*” ky qëndrim duhet pranuar sepse në themel merr parasysh kushtet objektive sociale, i përshtatet më mirë natyrës juridike të së drejtës së pronësisë dhe nuk vjen në kundërshtim me nenet 112, 114 dhe 149 të Kodit Civil. Megjithatë “*da lege ferenda*”, kur në legjislacion nuk ka ndonjë dispozitë që të parashikojë shprehimisht parashkrimin ose jo të padisë së rivendikimit, nisur nga konsideratat e mësipërme, vlerësojmë se nuk mund të parashkruhet e drejta e pronarit jo posedues për të kërkuar sendin nga çdo posedues apo mbajtës jo pronar.

39. Sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin njësoj se: **Padia e kërimit të sendit, parashikuar nga neni 296 i Kodit Civil, nga natyra e saj është një padi e pa parashkrueshme.**

40. Duke iu kthyer rastit konkret, Kolegjet e Bashkuara evidentojnë se paditësi Syl Hysaj, me pretendimin se është pronar mbi sipërfaqen prej 80 m², e cila i është zënë me ndërtim nga i padituri Kadri Hysa, bazuar në nenin 296 të Kodit Civil, ka kërkuar dorëzimin e kësaj sipërfaqeje.

41. Nëpërmjet prapësimeve, i padituri Kadri Hysa ka parashtruar se sendin objekt rivendikimi e ka blerë nga paditësi dhe se është në kushtet e fitimit të pronësisë me parashkrim fitues, bazuar në nenin 168 të Kodit Civil. Në vërtetim të këtij pretendimi i padituri ka paraqitur një deklaratë dore për shitje tokë truall, ku shitës figuron paditësi Syl Hysaj dhe blerës i padituri Kadri Hysa.

42. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, pasi ka pranuar të provuar se i padituri nuk vërtetoi origjinalitetin e deklaratës së dorës ku mbështet pretendimin se e ka blerë sipërfaqen objekt rivendikimi, ka pranuar padinë me arsyetimin se kjo deklaratë nuk ka fuqi provuese dhe se i padituri sipërfaqen në fjalë e mban pa asnjë titull.

43. Gjykata e apelit ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka rrëzuar padinë me arsyetimin se paditësi ka humbur posedimin e sendit që në vitin 1994, ndërsa padinë e ka ngritur në vitin 2005, pra tej afatit 10-vjeçar të parashikuar në nenin 114 të Kodit Civil. Në kuptim të nenit 112 të po këtij Kodi paditësit Syl Hysaj i është shuar e drejta e padisë.

44. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, mbështetur në konkluzionin e arritur më lart dhe në shqyrtim të akteve të dosjes gjyqësore, pretendimeve dhe prapësimeve të palëve, vendimeve të gjykatave të faktit dhe shkaqeve të rekursit, vlerëson se vendimi nr.181, datë 23.4.2007 i Gjykatës së Apelit Shkodër është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit dhe për këtë shkak duhet prishur.

45. Kolegjet e Bashkuara e vlerësojnë të gabuar arsyetimin dhe përfundimin e arritur nga gjykata e apelit, sipas së cilës padia objekt gjykimi është e parashkruar.

46. Referuar përfundimit njësoj të mësipërm, sipas të cilit padia e rivendikimit, bazuar në nenin 296 të Kodit Civil, është e pa parashkrueshme, dhe ndodhur në kushtet kur, për rastin në shqyrtim, rrëzimi i padisë është mbështetur vetëm në argumentin se padia është ngritur tej afatit të parashkrimit, pa analizuar në tërësi provat e paraqitura nga palët, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se argumenti i gjykatës së apelit është i pambështetur në ligj.

47. Për arsyet e mësipërme, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se vendimi i gjykatës së apelit duhet të prishet dhe çështja t’i dërgohet për rishqyrtim po asaj gjykate, me tjetër trup gjykues.

47.1. Në rigjykim, gjykata e apelit, për t'iu dhënë zgjidhje problemeve të mësipërme, në respektim të të drejtave të palëve dhe detyrimeve të tyre që rrjedhin nga procesi gjyqësor civil, “... ka për detyrë që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin (neni 14) dhe, duke bërë një “cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen” ta zgjidhë atë “në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi” (neni 16).

47.2. Gjykata t'u bëjë të qartë palëve se është detyrë e secilës prej tyre, që në përputhje me ligjin, të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm e provojnë faktet mbi të cilat bazojnë pretendimet për të drejtat që kërkojnë.

Në zgjidhjen e drejtë e ligjore të mosmarrëveshjes, ashtu si palët kanë të drejta, ato kanë dhe detyrime “që rrjedhin prej këtij procesi, në format dhe afatet e parashikuara” në Kodin e Procedurës Civile (neni 3”).

47.3. Gjykata e apelit për të garantuar një proces të rregullt ligjor, në mbështetje të neneve 486 e 465 të Kodit të Procedurës Civile, qoftë edhe kryesisht, duke mbajtur parasysh konkluzionet e mësipërme të këtij vendimi njësuës: i) duhet të përsërisë hetimin gjyqësor nëpërmjet të cilit të verifikojë e të identifikojë pretendimet e palëve, ii) duhet të verifikojë të drejtën e pronësisë së pretenduar të paditësit, mënyrën e fitimit të pronësisë, iii) duhet si dhe pretendimet e palës së paditur në lidhje me plotësimin ose jo të kushteve të kërkuara nga neni 168 i Kodit Civil për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues.

47.4. Po kështu, në rishqyrtimin e çështjes gjykata e apelit duhet të sqarojë të gjitha rrethanat që lidhen me ligjin e zbatueshëm dhe që kanë rëndësi për zgjidhjen e drejtë të çështjes.

48. Kryerja e veprimeve të mësipërme, si dhe e të tjerave që eventualisht mund të dalin gjatë rigjykimit, do ta lejojnë gjykatën e apelit që, në përputhje me kërkesat e ligjit procedural e atij material, të mund të arrijë në përfundime të drejta dhe objektive lidhur me zgjidhjen e çështjes.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të nenit 17 të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 485/ç të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSËN:

Prishjen e vendimit nr.181, datë 23.4.2007 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

Ky vendim është unifikues dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Anëtar pro: Shpresa Beçaj (kryesuese), Gani Dizdari, Ardian Dvorani, Fatos Lulo, Besnik Imeraj, Guxim Zenelaj, Aleksandër Muskaj, Andi Çeliku, Ardian Nuni, Evelina Qirjako, Mirela Fana
Anëtar kundër: Arjana Fullani, Majlinda Andrea, Medi Bici

MENDIMI I PAKICËS

1. Ne gjyqtarët në pakicë, Arjana Fullani, Majlinda Andrea dhe Medi Bici, kemi mendimin se vendimi nr.181, datë 23.4.2007 i Gjykatës së Apelit Shkodër, me të cilin është vendosur: “Ndryshimi i vendimit nr.2058, datë 9.11.2005 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe rrëzimi i kërkesë padisë” është rrjedhojë e respektimit të ligjit dhe, për këtë shkak, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë duhet ta linin në fuqi.

Pakica vlerëson se qëndrimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili ka arritur në përfundimin njësuës, sipas të cilit padia e rivendikimit, bazuar në nenin 296 të Kodit Civil, është e paparashkrueshme, nuk është në përputhje me parashikimin e qartë të dispozitave të ligjit.



Për të treguar arsyet pse pakica është e mendimit se padia e rivendikimit i nënshtrohet parashkrimit shues, duhet që të bëjmë një interpretim të zgjeruar të padisë, padisë së rivendikimit dhe lidhjen e saj me institutet e tjera të së drejtës, siç janë të përcaktuara në dispozitat e Kodit Civil.

Padia është mjete me të cilin mbrohen dhe rivendosen gjyqësisht të drejtat civile të shkelura, si dhe të drejtat që rrjedhin nga marrëdhëniet juridike të punës, familjare, etj....Në vetëvete nocioni padi përmban: të drejtën e padisë në kuptimin procedural dhe të drejtën e padisë në kuptimin material. E drejta e padisë në kuptimin procedural nënkupton të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, arbitrazhit ose një juridiksioni të posaçëm. Nga ana tjetër, e drejta e padisë në kuptimin subjektiv të saj përbëhet nga dy mundësi juridike të bartësit të saj, dhe konkretisht:a) nga mundësia për të kryer veprimet e treguara në normën juridike dhe b) nga mundësia për të kërkuar kryerjen ose moskryerjen e veprimeve të caktuara nga personi i detyruar.

Si një padi e llojit të veçantë, padia e rivendikimit është mjet kryesor juridiko-civil për mbrojtjen e së drejtës së pronësisë ndaj çdo cenimi, shkelje, ndërhyrje mbi sendin nga ana e personave të tretë, të cilët krijojnë një gjendje e cila nuk pajtohet me tagrat e pronarit për të poseduar, gëzuar e disponuar sendin (*Neni 149 i Kodit Civil përcakton se "Pronësia është e drejta për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufijve të caktuar nga ligji"*). Në thelb, kjo padi synon në kthimin e sendit, i cili i është hequr nga posedimi dhe që posedohet në mënyrë të paligjshme prej dikujt tjetër, nën posedimin e pronarit të ligjshëm (neni 296 i Kodit Civil.)

Padia e rivendikimit është një padi reale, e cila megjithëse drejtohet kundër një personi (cenuesit) ka për objekt të drejtpërdrejtë sendin, marrjen e tij prej kujtdo që e ka në posedim. Kusht thelbësor për ngritjen e padisë së rivendikimit është që paditësi të jetë pronar i sendit, personi i cili ka pronësinë mbi sendin në momentin që ngre padinë. Nga kjo rrjedh përcaktimi tjetër se: "*Padia e rivendikimit është padia e pronarit jo posedues kundër poseduesit jo pronar*".

Prej vitit 1953 e Drejta Civile Shqiptare ka mbajtur qëndrimin se padia e rivendikimit është një padi e cila parashkruhet njësoj si të gjitha paditë e tjera. Për shkak të karakterit ideologjik, legjislacioni i kësaj periudhe, ndonëse pranonte pa mëdyshje parashkrimin e padisë së rivendikimit midis personave fizikë, mbante një qëndrim të ndryshëm në lidhje me padinë e rivendikimit midis personave fizikë e atyre juridikë, si dhe midis personave juridikë.

Ky ndryshim ishte thellësisht ideologjik dhe lidhej me cilësimin e pronës shtetërore (socialiste) si një provë, e cila nuk i nënshtrohej të njëjtit rregullim si prona private për shkak të cilësive të saj dhe qëllimit të cilit ajo i shërbente.

Kodi Civil i vitit 1994 ndjek të njëjtën traditë në lidhje me parashkrueshmërinë e padive në përgjithësi dhe të padisë së rivendikimit në veçanti. Afati i përgjithshëm për parashkrimin e padive parashikohet në nenin 114 të Kodit Civil, i cili përcakton se: "*Kur në ligj nuk është parashikuar ndryshe parashkruhen brenda dhjetë vjetëve të gjitha paditë midis personave juridikë, midis këtyre dhe personave fizikë, si dhe midis vetë personave fizikë*". Përkundër këtij përcaktimi në nenin 113§1 të Kodit Civil përcaktohen specifikisht paditë të cilat nuk parashkruhen, duke quajtur si të tilla: "*a) Padia për rivendosjen ose mbrojtjen e një të drejte vetjake jopasurore përveç përjashtimeve të caktuara në ligj; b) Paditë e njohjes; c) Padia e pjesërimit midis bashkëpronarëve; d) Padia për kthimin e shumave të depozituara në bankë; e) Paditë e tjera të parashikuara në dispozita ligjore të veçanta*".

Edhe pakica, siç pranon dhe argumenton me të drejtë shumica, mendon se "*mungesa e një dispozite konkrete në lidhje me parashkrimin ose jo të padisë së rivendikimit nuk do të thotë se a priori kjo padi është e parashkrueshme*". Doktrina pranon se pavarësisht mosparashkimit specifik në ligj, për vetë natyrën e tyre, disa padi janë të paparashkrueshme. Padia mohuese, e cila së bashku me padinë e rivendikimit janë dy paditë kryesore të pronarit të sendit për mbrojtjen e pronësisë, është konsideruar gjithmonë si padi e paparashkrueshme, pavarësisht se kjo karakteristikë e saj nuk ka qenë dhe nuk është specifikuar në një dispozitë të veçantë të Kodit Civil. Duke pranuar këtë parim, nuk mund të mos përmendim ndryshimin kryesor midis këtyre dy padive, ndryshim i cili në pikëpamjen e pakicës, i jep padisë mohuese ato karakteristika të cilat, në ndryshim nga padia e rivendikimit, e bëjnë atë të paparashkrueshme.

Në ndryshim nga padia e rivendikimit, padia mohuese, konsiston në të drejtën e pronarit i cili nuk është zhveshur nga posedimi të kërkojë nga kushdo “..... që e cenon në pronësinë e tij..... të pushojë cenimin dhe të mos përsërisë këtë në të ardhmen, dhe, kur është rasti të shpërblejë dëmet që mund t'i ketë shkaktuar” (neni 302 i Kodit Civil). Moszhveshja e pronarit nga posedimi i sendit si parakusht për ngritjen e kësaj padie, bën që çdo cenim mbi tagrat e pronarit posedues të konsiderohet cenim me karakter vazhdues e për rrjedhojë” “sado e largët të jetë koha në të cilën ka filluar cenimi gjersa ky cenim vazhdon ose ka filluar, padia mohuese mund të ngrihet lirisht sepse në këto kushte as që mund të bëhet fjalë për parashkrim shues të saj”.

Për rrjedhojë, në kushtet kur padia e rivendikimit në dallim nga padia mohuese nuk mund të konsiderohet e parashkrueshme për shkak të natyrës së saj si dhe në referim të neneve 113 dhe 114 të Kodit Civil, pakica mendon se vullneti i legjislatorit për të konsideruar padinë e rivendikimit si padi e cila parashkruhet është shprehur qartësisht, pasi nga njëra anë ai përcakton rregullin e përgjithshëm se të gjitha paditë parashkruhen, me përjashtim të atyre që shprehimisht konsiderohen të paparashkrueshme, dhe nga ana tjetër qëllimisht nuk përfshin edhe këtë lloj padie në listën shteruese të atyre padive që konsiderohen të paparashkrueshme.

Gjithashtu i ndryshëm është mendimi i pakicës edhe në lidhje me përfundimin tjetër të shumicës se “e drejta e pronësisë nuk mund të humbasë nga përdorimi, edhe sikur pronari të mos ketë përdorur sendin e vet për një kohë të gjatë. Pronari nuk e humbet të drejtën e ushtrimit të padisë së rivendikimit derisa i padituri nuk ka fituar pronësinë me parashkrim fitues”.

Fitimi dhe humbja e pronësisë gjen rregullim të veçantë në dispozitat e Kodit Civil, kreu II, nenet 162 e vijues të tij. Neni 168 i Kodit Civil përcakton se: “Personi që ka fituar me mirëbesim një send, në bazë të një veprimi juridik për kalimin e pronësisë dhe që nuk është i ndaluar nga ligji, bëhet pronar i këtij sendi, pas një posedimi të pandërprerë prej pesë vjetësh kur sendi është i luajtshëm dhe prej dhjetë vjetësh kur ai është i paluajtshëm. Kur posedimi nuk është me mirëbesim, afatet e posedimit të pandërprerë dyfishohen. Posedimi konsiderohet i pandërprerë edhe kur fituesi i sendit ia ka dhënë posedimin një personi tjetër. Nuk mund të fitohet me parashkrim fitues një send që është pronë publike e patjetërsueshme”. Nga ana tjetër neni 191 i Kodit Civil parashikon se: “Pronësia humbet kur fitohet nga një tjetër ose kur hiqet dorë prej saj. Heqja dorë nga pronësia mbi pasuritë e paluajtshme në dobi të një tjetri, është e vlefshme kur bëhet me akt noterial e regjistruhet”.

Parashkrimi i padisë në përgjithësi dhe i padisë së rivendikimit në rastin tonë, përmban dy elemente thelbësore: a) kalimin e një periudhe të caktuar kohe, të caktuar nga ligji; dhe b) mosveprimin gjatë gjithë kësaj kohe të subjektit për të kërkuar një të drejtë civile të shkelur ose të kundërshtuar (pronari). Është pikërisht mosveprimi i pronarit të sendit në kushtet kur atij i kishte lindur e drejta e padisë dhe nuk kishte asnjë pengesë ligjore për të ushtruar të drejtën brenda afatit të përcaktuar me ligj që shkakton shuarjen e së drejtë së padisë, e cila nuk çon në humbjen e pronësisë mbi sendin por shuan të drejtën për të përfutur mbrojtjen që të jep ligji. Me fjalë të tjera, mosparaqitja e padisë brenda afatit të parashkrimit të caktuar nga ligji shuan mundësinë për të realizuar në mënyrë të detyrueshme, shtrenguese, nëpërmjet gjykatës, të drejtën e shkelur nga të tretët.

Pavarësisht se pronari humbet mundësinë për të fituar mbrojtjen shtetërore të së drejtës që i është shkelur, pala tjetër në shumicën e rasteve nxjerr një dobi nga kjo humbje, por nuk fiton një të drejtë. Pranohet gjerësisht prej së drejtës se pronari e humbet pronësinë në të gjitha rastet që një person tjetër e fiton këtë, qoftë edhe kundër vullnetit të pronarit. Në rastin tonë, pronarit joposuedes, i cili për shkak të kalimit të afatit nuk mund të kërkojë kthimin e sendit prej poseduesit jopronar, nuk i ka humbur ende e drejta e padisë në kuptimin material (pronësia mbi sendin), por vetëm e drejta e padisë në kuptimin procedural, e drejta për ta ushtruar këtë të drejtë nëpërmjet urdhërimeve të gjykatës.

Në çdo rast, shuarja e së drejtës së padisë nuk mund dhe nuk duhet të interpretohet si humbje/parashkrim edhe e të drejtës së prapësimin themelor ose substancial. Prapësimin themelor quhet mjeti juridik me të cilin pala e paditur, pa mohuar të drejtën e paditësit, mbrohet duke parashtruar rrethana të cilat ndalojnë pranimin e kërtimeve të palës paditëse dhe e mbajnë konfliktin gjyqësor brenda kufijve të kërkesë padisë. Me fjalë të tjera kemi prapësimin kur të drejtës së paditësit i kundërvihet një e drejtë e të paditurit, e cila për shkak të rrethanave të veçanta të marrëdhënive juridike përkatëse dhe pa



e zgjeruar gjykimin e çështjes përtej kufijve të kërkesë padisë paralizon pranimin e kërkimeve të parashtruara në atë kërkesë padi. Është pikërisht ekzistenca e kësaj të drejte e cila i jep kuptim parashkrimit të kësaj padie, në kuptimin procedural, duke pranuar gjithashtu se e drejta e pronësisë mbetet ende me pronarin deri në momentin kur pala tjetër fiton titull pronësie mbi sendin në kushtet e parashikuara nga neni 169 i Kodit Civil “*Personi që ka poseduar qetësisht e pa ndërprerje, duke u sjellë sikur të ishte pronar për njëzet vjet në një pronë të paluajjtshme, bëhet pronar i saj*”.

Për gjithë sa më sipër, pakica del në përfundimin se **padia e rivendikimit, sipas përcaktimeve në Kodin Civil aktual, është një padi e cila parashkruhet (parashkrim shues) me kalimin e një afati 10-vjeçar**, i cili sipas nenit 119 të Kodit Civil: “.....fillon nga dita kur pronari ka marrë ose duhej të merrte dijeni për cenimin dhe cenesin e së drejtës së tij”. Afati i parashkrimit të padisë së rivendikimit fillon nga dita që pronarit i është cenuar e drejta e pronësisë me heqjen e posedimit të tij dhe jo nga dita që ka marrë dijeni për cenimin dhe cenesin. Kjo gjë lidhet me faktin se për sendin e paluajjtshëm është pothuajse e pamundur që zhveshja nga posedimi të ndodhë në mënyrë të fshehtë dhe nga ana tjetër pronari i qëndron afër sendit dhe interesohet vazhdimisht për të. Për rrjedhojë, në ndryshim nga paditë për rivendikimin e sendeve të luajjtshme ku pranohet se afati fillon nga momenti i marrjes dijeni të ligjit ose ku parashikohet shprehimisht ky rregull i përgjithshëm (neni 183 i Kodit Civil), afati i përgjithshëm 10-vjeçar i mundëson pronarit që brenda një afati që mund të shkojë deri në 10 vjet nga heqja e posedimit të sendit, ta kërkojë atë nga çdo posedues i paligjshëm.

Në rastit konkret, gjyqtarët në pakicë mendojnë se vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër, i cili ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe ka rrëzuar padinë me arsyetimin se paditësi ka humbur posedimin e sendit që në vitin 1994, ndërsa padinë e ka ngritur në vitin 2005, pra tej afatit 10-vjeçar të parashikuar në nenin 114 të Kodit Civil dhe në kuptim të nenit 112 të po këtij Kodi paditësit Syl Hysaj i është shuar e drejta e padisë, është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Anëtarë: Medi Bici, Majlinda Andrea, Arjana Fullani.

VENDIM

Nr.147/1, datë 7.12.2011

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË AKSESIT NË RRJETIN E SHPËRNDARJES SË ENERGISË ELEKTRIKE PËR PERIUHDHËN E TRETË RREGULLATORE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.79, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e “CEZ shpërndarje” sh.a., për përcaktimin e tarifës së aksesit në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën e tretë rregullatore dhe relacionin e grupit të punës,

VENDOSI:

1. Tarifa e aksesit në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën e tretë rregullatore (vitet 2012-2014), do të jetë:
Në TM - 3.2 lekë/kWh.
Në TU - 5.4 lekë/kWh.
2. Ngarkohen Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e “CEZ shpërndarje” sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2012.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.152, datë 7.12.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA “HEC
BISTRICA 1, 2” SHA PËR PERIUdhËN E TRETË RREGULLATORE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 pika 1, 27 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, pikat 4.13, neneve 15, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, vendimit nr.77, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2011, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve për përcaktimin e tarifës për prodhimin e energjisë elektrike nga “Hec Bistrica 1, 2” sh.a., për periudhën e tretë rregullatore,

VENDOSI:

1. Tarifa e prodhimit të energjisë elektrike nga “Hec Bistrica 1, 2” sh.a., për periudhën e tretë rregullatore (vitet 2012-2014), do të jetë 2.2 lekë/kWh.
2. Ngarkohen Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e “Hec Bistrica 1, 2” sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2012.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.153, datë 7.12.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA “HEC
LANABREGAS” SHA PËR PERIUdhËN E TRETË RREGULLATORE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 pika 1, 27 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, pikat 4.13, neneve 15, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, vendimit nr.77, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2011, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve për përcaktimin e tarifës për prodhimin e energjisë elektrike nga Hec Lanbregas, për periudhën e tretë rregullatore,



VENDOSI:

1. Tarifa e prodhimit të energjisë elektrike nga “Hec Lanabregas” sh.a., për periudhën e tretë rregullatore (vitet 2012-2014), do të jetë 6.25 lekë/kWh.

2. Ngarkohen Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e “Hec Lanabregas” sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2012.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr.154, datë 7.12.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“ULËZ SHKOPET” SHA PËR PERIU DHËN E TRETË RREGULLATORE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 pika 1, 27 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, pikat 4, 13, neneve 15, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, vendimit nr.77, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2011, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve për përcaktimin e tarifës për prodhimin e energjisë elektrike nga “hec Ulëz Shkopet” sh.a., për periudhën e tretë rregullatore,

VENDOSI:

1. Tarifa e prodhimit të energjisë elektrike nga “Hec Ulëz Shkopet” sh.a., për periudhën e tretë rregullatore (vitet 2012-2014), do të jetë 2.72 lekë/kWh.

2. Ngarkohen Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e “Hec Ulëz Shkopet” sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2012.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

**Tabelë e munguar e vendimit nr.359, datë 4.5.2011 “Për miratimin e kalimit të pronësisë së disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale”,
botuar në Fletoren Zyrtare nr.70, datë 8.6.2011**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
TË DHËNAT SIPAS LISTËS EMËRORE PËR KALIM PRONËSIE
Qarku DIBËR, Bashkia Peshkopi
Emërtimi i territorit: Qyteti Peshkopi Zona Kadastrale 2932

Nr. rendor	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr. i prot. të vetdëklarimit	Nr. i pasurisë	Sipërfaqja e parcelës m ²	Sipërfaqja e bazës së ndërtimit m ²	Nr.kateve
1	2	3	4	5	6	7	8	9
1	PERVIS	ADEM	MERA	65	19/50	300	120	2
2	VEHAP	MYRTEZA	GJURA	145	9/23	357.00	300	3
3	ALMENT	ABDULLAH	HOXHA	163	11/12	100.40	89	1
4	BENAN	SUBI	GROSHA	118	5/301	280.00	114	1
5	RAKIP	SUBI	GROSHA	119	5/300	272.00	114	1
6	RAHIM	DULEJMAN	SHULKU	31	4/34	300.00	147	1

Sip. totale për kalim pronësie: 1609m²



**Tabelat e munguara të vendimit nr.822, datë 23.11.2011 “Për miratimin e kalimit të pronësisë së disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale”,
botuar në Fletoren Zyrtare nr.167, datë 29.12.2011**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale
Shtesat sipas formularit A1, para vitit 1993
QARKU KORÇË, BASHKIA KORÇË, ZK 8562

Nr. rendor	Nr. i objekteve	Të dhënat e vetëdeklaruesit			Të dhënat për shtesën					
		Emër	Atësia	Mbiemri	Nr. prot. vetëdeklarimit	Kati i me funksion banimi	Nr. i kateve	Nr. pasurisë	Sip. e ndërtimit (sip. e bazës)	Sipërfaqja e parcelës ndërtimore për kalim pronësie (m ²).
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	1	ELTON ILIAS	NIKO AXHEM	TROJA RAMO	A1-932	k.p.1	2	4/876	58.65	58.65



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
TË DHËNAT SIPAS LISTËS EMËRORE PËR KALIM PRONËSIE
Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Qarku Korçë
QARKU KORÇË, KOMUNA VRESHTAS
VRESHTAS
Zona kadastrale 3830

Nr. rendor	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	Nr. i prot. vetëdeklarimit	Nr. i pasurisë	Nr. i kateve	Sipërfaqja e bazës së ndërtimit m ²	Sipërfaqja e parcelës m ²
1	2	3	4	5	6	7	8	9
1	VANGJEL	SABRI	FETOLLARI	A-16/9	392/21	1 K	96	241.78
TOTALI								241.78



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
TË DHËNAT SIPAS LISTËS EMËRORE PËR KALIM PRONËSIE

Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Qarku Korçë

Qarku Korçë, Bashkia POGRADEC

LAGJA Peroi i Çaprazit

Zona kadastrale 8582

Nr. rendor	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	Nr. i prot. vetëdeklarimit	Nr. i pasurisë	Sipërfaqja e parcelës m ²	Sipërfaqja e bazës së ndërtimit m ²	Nr. i kateve
1	2	3	4	5	6	7	8	9
1	QEMAL	MERSIN	HYKO	A-127	5/403	105.6	42	1KT
TOTALI						105.6		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
TË DHËNAT SIPAS LISTËS EMËRORE PËR KALIM PRONËSIE

Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Qarku Korçë

Qarku Korçë, Bashkia Korçë, lagja 15

Zona kadastrale 8563

Nr. rendor	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	Nr. i prot. vetëdeklarimit	Nr. kateve	Nr. i pasurisë	Sipërfaqja e bazës së ndërtimit m ²	Sipërfaqja e parcelës m ²
1	2	3	4	5	9	6	8	7
1	AVNI	MUHAMET	PETRITI	A - 885	1	3/940	26.2	130.3
TOTALI								130.3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale

Shtesat sipas Formulari A1,

QARKU KORÇË, BASHKIA KORÇË, ZK 8561

Nr. rendor	Nr. i objeteve	Të dhënat e vetëdeklaruesit			Të dhënat për shtesën					
		Emër	Atësia	Mbiemri	Nr. prot. vetëdeklarimit	Kati i me funksion banimi	Nr. i kateve	Nr. i pasurisë	Sip. e ndërtimit (sip. e bazës)	Sipërfaqja e parcelës ndërtimore për kalim pronësie (m ²).
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	1	KOSTAQ	MIALLAQ	REMBECI	A1-522	Kp,1	2	3/1004	21.1	34.15
		BESNIK	SELIM	SPAHO						



Ndreqje gabimi

Në vendimin nr.822, datë 23.11.2011, botuar ne Fletoren Zyrtare nr.167, datë 29.12.2011, në faqen 8499, tabela e dytë bëhet si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale
Shtesë sipas formularit A1
Qarku Fier, rajoni nr. 1, zona kadastrale 8531, blloku nr.6'2, lagjja "11 Janari"

Nr. Rendor	Të dhënat e vetëdeklaruesit			Të dhënat për shtesën					
	Emër	Atësia	Mbiemri	Nr. prot. vetëdeklarimit	Kati i banimit	Nr. i kateve	Nr. pasurisë	Sip e ndërtimit (sip e bazës)	Sipërfaqja e parcelës ndërtimore për kallim pronesie (m ²)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	PERLAT	ILJAS	JAUPAJ	2	k.p	4	6/369	78.7	78.7
	NATASHA	HALIT	KACANOLLI		k.1				
	DRITAN	ARISTOTEL	VERRIA		k.2				
	LLAZAR	THANAS	LOCI		k.3				
SHUMA TOTALE:								78.70	78.7

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 20.2.2012

Doli nga shtypi më 22.2.2012

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 36 lekë